



PÉSEDHJËTORË É VOGEL
É KTHYËR NGA GEROISHTJA

PÉSEDHJËTORË
Ë VOGEL
Ë KTHYËR NGA GERQISHTJA

PRËJ

PRIFTIT ORTHODOKS F. S. NOLI



BOSTON, MASS.

1914

T' IM-ÉTI,
QE ME RRTI É ME MESOJ,
DHÉ QE VDIQ I LENDUAR,
SÉ ME PA PRIFT,
I DÉDIKOJ KETÉ LIBRE,
DYKÉ I LYPUR NDJÉSE.

KTHÉNJESI.

PARETHÉNIE

Po u jap Shqipetarevé orthodoxe tri libra kishetaré ketê mot : Triodin, Péshedjétorén, dhé Lutjésorén. E para u-shtyp mé harxhét é nje guverné miké, dy te tiérat mé ndihma te Shqipetarevé. Po jap ne funt te ketyré libravé listen é ndihmetarevé. Nuke duhét harruar qe, per te shtypur ketô libra, bêra dy udhetimé te kushtushmé, héren é pare nga Boston-i ne Odése, Bukurésht, Braille, Konstance, Sofjé, Paris, dhé s'andéjmi prape ne Boston, héren é dyte nga Triéshti ne Bukurésht dhé s'andjémi prape ne Triésht. Ketô udhetimé me kushtuan mê téper sé 3500 frénga. Mé parate qe me mbétne, pagova harxhét é shtypit per Péshedjétorén dhé Lutjésorén.

F. S. NOLI.

I shkurt, 1914.

E DIÉLA É SHÉNJTE É PASHKES SE MADHÉ

SHERBËSA É MENGJËZIT DHË É MËSHES

Ne més te nates, passi békon Prifti, « *Lavdi ty, ô Pérendia jone, lavdi me ty* », « *Shent Pérendi* », « *Meshirô, ô Zot* » 12 hère, Lavdi é Tanì « *Ejani lé t' i jalémi* » 3 hère, Psalmi 51, pastaj Kanuni i se Shtunes se Madhé. Pas kënges IX te Kanunit, « *Shent Pérendi* » ne Alltar, Tropari « *Kur zbrité té vdékja* », Litanì é Gjére dhé Perleshim.

Pastaj dél Prélati a Prifti nga Dér' é Bukur, mé nje qiri te ndézur ne dore, préj te cilit ndézin populli, dyké u-kenduar tri hère ky Tropar :

T. T. I. — Eni mérrni drite préj drites qe s'pérendon dhé lavderoni Krishtin qe u-ngjall se vdékuresh.

Pastaj dalin jashte Kishes, dyké kenduar ketê Tropar :

T. T. II. — Ngjalljén tëndé, ô Krisht Shpetimtar, Engjejte hymnojne ner qiéjte; vléresô-na dhé né mi dhé te te lavderojme mé zemer te paqmé.

Passi arrijne té vendi i prégatitur, Diaku therrét « Dhé qe te vléresohémi », dhé kendohét préj Prélatit a Priftit Ungjilli i Mbrêmesorés se Shtunes se Madhé, a Ungjilli Mengjézor II.

Pastaj Prélati thote mé zê te larte :

Lavdi Trinise se Shénjte, se bashkeqênurshmé dhé se pandare, pergjithmone, tanì é perhére, é ne jéte te jétevé. Amen.

Dhé mé nje hère kendohét :

T. T. I. — Krishti u-ngjall se vdékuresh, mé vdékjé vdékjén shkéli édhé te varrosuvé u fali jéten.

Thuhét tri hère préj Priftit dhé 6 hère préj Vallévé mé ketà VARGJÉ :

Lé te ngjallét Pérendia, dhé lé te perndahén armiqt' é tij, dhé lé te ikin préj faqés se tij atà qe i kane meri.

Si debirét tymi, lé te debirén, si shkrin qiriu nga faq' é ziarrit.

Ashtu do te humbasin mekataret préj faqés se Pérendise, dhé te dréjtet do te defrèjne.

Kjo eshte dita qe bëri Zoti; lé te ngazellohémi é lé te defrèjme ne të.

Lavdi Atit, é Birit édhé Shpirtit Shénjt.

Tani é perhére, é ne jéte te jétevé. Amen.

Pastaj Prifti thote « *Krishti u-ngjall* » dhé mérr fundin Vallja. Litani é Madhé dhé Thirrja « *Sé ty te ka hié ç'dó lavdi, étj.* Passi hyjne ne Kishe, kendohét ky KANUN, T. I.

Kênge I.

Dit' é Ngjalljés ! Lé te ndriçohémi, ô popuj. Pashka é Zotit, Pashka ! Sé préj vdékjés té jéta dhé préj dhéut ne qiéll na shpuri Krishti Pérendia jone, dyké kendar kênge mundesé.

Lé te paqesojme ndjénjat, dhé do te shohim mé driten é paaferuar te Ngjalljés Krishtin qe vétetin, dhé do t'a degjojme te thote me zê te larte Gezohuni, dyké kendar kênge mundesé.

Qiejte lé te defrèjne, siç vlén, dhé lé te ngazellohét dhéu, dhé tëre bota é dukur dhé é padukur lé te krémterroje, sé u-ngjall Krishti, gezimi i amëshuar.

Pas ç'dó Kêngé thuhét tri hère « Krishti u-ngjall » dhé pastaj ky Tropar :

Kur u-ngrit Jësuj préj varrit, siç paretha, na dha jéten é amëshuar dhé perdellimin é math.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Sé jotja eshte potéra... »*

Kënge III.

Eni te pime nje te pire te ré, qe s' dél çuditerisht préj nje shkëmbi te thate, po burimin é paprishjés qe kecén préj varrit te Krishtit, me te cilin shigurohémi.

U-mbushne mé drite te gjitha tanì, qiëlli é dhéu dhé te nenedhëshmét; lé te krémterroje pra tère Kriésa Ngjalljén é Krishtit, me te cilen shigurohét.

Dié varrosesha mé ty, ô Krisht, ngrihém mé ty sot qe u-ngjallé; kryqesohesha dié mé ty; ti me lavderô bashke, ô Shpetimtar, ne mbréteri tëndé.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Sé ti jé Pérendia jone...* »

Degjim. — T. IV.

Kur ardhe Grate mé Marine para agimit dhé gjétne gurin te rrugullizur, degjonin préj Engjellit : Até qe rron té drit' é amëshuar si é kerkoni si njéri mé te vdëkurit? Réntni dhé i leçitni botes si u-ngrit Zoti, dyké vrare vdëkjén; sé eshte i Bir' i Pérendise, qe shpeton gjindjén é njéresvé.

Kënge IV.

Lé te qendroje mé né Hyjfolesi Abbakum mi ruajtjén é pérendishmé, dhé lé te rreféje Engjellin dritesiëlles qe therrét shëshit : Sot vjén shpetimi té bota, sé u-ngjall Krishti si i terefuqishim.

Krishti u-tréguva mashkull, sé çéli gjirin virgjeror; si njéri u-quajt qénq i pacinuar, sé nuke njohu njolle, Pashka jone; dhé si Pérendi é vertéte, quhét i mbaruar.

Si qénq i permoteshim, thérét per te gjithë vullnétarisht kurora jon' é mire é békuar, Pashka paqesoré; dhé perseri préj varrit na ndriti i bukuri diéll i dréjtesise.

Hyjprindi David u-hoth, dyké kecyér perpara arkes se hiëshmé; dhé né, populli i Pérendise i shénjte, dyké

shikuar mbarimin é symbolévé, lé te defréjme hyjerisht, sé u-ngjall Krishti si i terefuqishim.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Sé ti jé Pérendi é mire dhé njëridashesé... »*

Kéngé V.

Lé te mengojme qe mé-nate, dhé lé t' i blatojme Zotit hymne ne vent te myrres, dhé do te shikojme Krishtin, diéllin é dréjtesise, qe u lint jéten te gjithévé.

Kur pane meshiren téndé te pamatur atà qe permbaheshin ner radhet é Férrit, ô Krisht, shpéjtonin té drita mé kêmbe te ngazelluar, dyké trokitur Pashke t' améshuar.

Lé t'i dalim perpara mé lampadé ne dore Krishtit qe dél préj varrit, si nje dhëndërri, dhé lé te krémterojme mé urdherét krémtofilé Pashken shpetimtaré te Pérendise.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Sé este i békuar émeri yt dhé é lavderuar mbréteria joté... »*

Kéngé VI.

Zbrité ne mê te poshtmét é dhéut dhé dermové llozét é perjéteshme, qe mbanin te burgosurit, ô Krisht, dhé pas tri ditsh, si Jonaj préj balénes, kecévé jashte préj varrit.

Dyké ruajtur shilat te pangara, ô Krisht, u-ngrité préj varrit, ti, qe nuke cenové klyçét é virgjeréshes me lindjén téndé, dhé na çélé dyért é Parajsjes.

O Shpetimtari im, viktim' é pathéreshmé qe me fal jéte, dyké i blatur vétén Atit vullnétarisht, ngjallé Adamin mé gjithé gjindjén é tij, kur u-ngjallé préj varrit.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Sé ti jé Mbré' i Botes... »*

Shkurtoré. — T. T. IV.

Mé gjithë qe zbrité ne varr, ô i Pavdékeshme, po rrezové potéren é Férrit; dhé u-ngjallé si mundes, ô Krisht Pérendi, dyké u thêne Gravé Myrrepruresé « Gezohuni », dhé Apostujvé te tû u dhurové paqen, ti qe u fal ngjalljén te rênevé.

Shpia.

Diéllin para diéllit, qe pérendoj nje hère ne varr, dyké menguar qe mé-nate, vane t'a kerkonin si dite Vajzat Myrrepruresé dhé i therrisinin njëra tiatres : Eni, ô miqéshta, t'a lyéjme mé aroma trupin jéteprures te varrosur, trupin é shtrire ne varr, qe ngjall Adamin fajtor. Eni, shpéjtoni, si Maget, t' i falémi é t' i blatojme myrra per dhurata jo te peshtiéllurit ner shpergij, po ne prokof, dhé lé te qajme é te therrésim : Ngjallu, ô Zot, qe u fal ngjalljén te rênevé.

Synaksar.

Te Diélen é Shénjte te Pashkes se Madhé krémterojme véte Ngjalljén jétepruresé te Zotit, dhé Pérendise, dhé Shpetimtarit tone Jésu Krisht.

Vark. — Krishti zbriti kunder Férrit vétem.

U-ngjit si mori shume plaçka mundjéjé.

E Ati eshte lavdia dhé potéra ne jéte te jétevé. Amen.

Pastaj thuhén per se tréti : « Mé-qène-qe pame Ngjalljén é Krishtit » dhé « Kur u-ngrit Jésuj préj varrit ».

Kênge VII.

Ay qe shpetoj Diémat préj furres, passi u-bê njëri, peson si i vdékshim, dhé mé pesimin é tij vësh njërine mé mirhiésin' é paprishjés, Pérendi é Atervé tane, i vétemi i békuar dhé i permilavdishim.

Grate Hyjmendesé mé myrra te réntne pas; dhé

atê qe kerkonin mé lot si te vdékshim, é adhuruan mé gas si Pérendi te gjalle, ô Krisht, dhé Pashken myshtiké u ungjillezuan Dishépujvé te tû.

Krémterojme vrasjén é vdékjés, rrezimin é Férrit, nisjén é nje jété tiater t' améshuar; dhé, dyké kecyér, hymnojme shkaketarin, Pérendin' é Atervé tane, te vétemin te békuar dhé te permilavdishim.

Mé te vertéte é shénjte dhé é krémteruar préj te gjithévé kjo nate shpetimtaré dhé é ndriçimé, qe parelajmeron ditén é shkelqyér te Ngjalljés, me te cilen drita pa-mot u shkelqéu te gjithévé préj varrit truperisht.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Qofte potéra é Mbréterise s' até é békuar dhé é lavderuar...* »

Kênge VIII.

Kjô eshte dit' é zgjédhur dhé é shénjte, é para dit' é javes, mbréteréshta dhé zonja, é krémt' é te krémtévé, dhé panair' i panairévé, me te cilen békojme Krishtin per jété.

Eni, me ditén é shenuar te Ngjalljés, te kungojme préj pémes se ré se vréshtes, préj defrimit te hyjeshme, préj mbréterise se Krishtit, dyké é hymnuar per jété.

Ngrér syte rréth téjé, Sion, dhé shikô; ja sé ku te vijne bijt' é tû, te hyjndriçim si yj, nga pérendimi dhé nga vériu, nga déti dhé nga lindja, dyké békuar me ty Krishtin per jété.

At' i trefuqishim dhé Fiale dhé Shpirt, natyr' é bashkuar me tri substanca, i permiqênurshme dhé i permihyjeshme, me ty jémi pagezuar dhé ty te békojme per gjithé jétet.

Litani é Vogel dhé Thirrja : « *Sé i békuar eshte émeri yt dhé é lavderuar Mbréteria joté...* ».

Pastaj DIAKU : « *Hyjlindesën dhë Mëmen é Drites mé hymné ndërimi lé t' a lavderojme* », dhë kendohët :

Kënge IX.

Madheshtë, ô shpirti im, atë qe, dyké dashur, pesoj dhë u-varros dhë u-ngjall pas tri ditsh përj varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, ô Jérusalém i ri, sé lavdi' é Zotit lindi permi ty; loj vallé tanì dhë ngazellohu, ô Sion, dhë ti, ô Hyjlindesé é qashter, defré me Ngjalljén é t'yt Biri.

Madheshtë, ô Shpirti im, Krishtin jétedhënes, qe u-ngjall pas tri ditsh përj varrit.

Ndriçohu, ndriçohu...

Krishti eshte Pashk' é ré, théroréja é gjalle, qéngj' i Pérendise qe ngré mekatin é botes.

O zër' i hysjhim, i dashur, édhé fort i embell! sé mé né u-zotové mé te vertéte te jësh gjér ne mbarim te jétes, ô Krisht; dhë ketë ankur shpetimi dyké patur, né bésniket ngazellohémi.

Sot kriés' é tère gezohët é ngazellohët, sé Krishti u-ngjall dhë Férrì u-plaçkua.

O zër' i hyjshim,...

Lavdi. — Madheshtë, ô shpirti im, potéren é Hynise se triqênurshmé dhë se pandare.

O Pashka é madhé dhë hiéroré, ô Krisht; ô urtesí dhë Fiale dhë fuqì é Pérendise! Vlérésô-na te marrim piése shëshit té dita é pambrémeshme é mbréterise s' até.

Tani. — Gezohu, Virgjeréshe, gezohu; gezohu, é békuar; gezohu, é lavderuar; sé Biri yt u-ngjall pas tri ditsh përj varrit.

O Pashka é madhé...

Zbritesoré.

Engjelli i therristé Hirplotés : Gezohu, Virgjerësh' é qashter, dhë prape te thom, Gezohu; sé Biri yt u-ngjall pas tri ditsh përj varrit.

Ndriçohu, ndriçohu...

« *Krishti u-ngjall* » tri hére, « *Kur u-ngrit Jësuj prëj varrit* » nje hére, Litanì é Vogel dhé Thirrja : « *Së ty te kendojne gjithë fuqit' é Qiëjvé...* ».

Dergimesoré. — T. II.

Si fiété truperisht si njëri, ô Mbrét dhé Zot, u-ngjallé i triditeshme, ngrité Adamin nga prishja, dhé abolité vdékjén. Pashka é paprishjés, shpetimi i Botes (*tri hére*).

LAVDERIMÉ. — T. T. I.

Kendohén kater te parat Vargezimé Ngjalljësoré te Tingellit I, pastaj ketô te Pashkes, mé keto vargjé :

Lé te ngjallét Pérendia dhé lé te përndahén...

Pashka hiëroré na u-çfaq névé sot; Pashk' é ré, é shénjte, Pashka myshtiké, Pashk' é gjithendëruar, Pashka, Krihsti çperblénjes, Pashka é panjollëshmé, Pashk' é madhé, Pashka é bésnikevé, Pashka qe na çéli dyért é Parajses, Pashka qe shénjteron gjithë bésataret.

Si debirét tymi, lé te debirén...

Ejani prëj pamjés, Gra mirelajmeronjesé, dhé Siones thojini : Prit prëj nésh ungjillezimé gazi te Ngjalljés se Krishtit; defré, dhé gezohu, dhé ngazellohu, ô Jérusalém, dyké pare Krishtin Mbrét te kecëje si dhënderr prëj varrit.

Ashtu do te humbasin mekataret...

Grate Myrrepuresé qe mé-nate qendruan té varr' i Jétedhënesit, gjétne nje Engjell qe rrinté mi gurin, dhé ay u foli keshtu, dyké thëne : Si kerkoni te gjallin mé te vdëkurit? Si vajtoni si me prishjë te paprishurin? Çapni dhé leçituni Dishëpujvé te tij.

Kjô eshte dita qe é bëri Zoti...

Pashka é gezuar, Pashka é Zotit Pashka, Pashk' é gjithendëruar na lindi, Pashka, mé gas lé te perqafojme njëri tjatrën, ô Pashke, çperblim i hélmit, sé Krishti sot shkelqéu prëj varrit si prëj nuserorjé, dhé i mbushi

Grate mé gezim, dyké thêne : Leçituni Apostujvé.

Lavdi é Tanì. — Dit' é Ngjalljés, lé te ndrìçohémi préj panairit dhé lé te perqafojme njêrijatrin; lé t' u thémi, ô vellézer, dhé atyré qe na urréjne; lé t' i ndjéjme te gjitha me ditén é Ngjalljés dhé keshtu lé te therrésim : « *Krishti u-ngjall se vdékuresh, mé vdékjé vdékjén shkéli édhé te varrosurvé u fali jéten (tri hère).* »

Passi békon Prifti, thuhét « *Krishti u-ngjall* » 10 hère mé Vargjét si mè siper.

NE MÉSHE

Hyrtoré.

Ner Kisherat békoni Pérendine, Zotin préj burimit t' Israélit. Shpetô-na, ô i Bir' i Pérendise, qe u-ngjallé se vdékuresh, né qe te kendojme : Alleluia.

Para sé te dale Prifti mé Ungjillin, kendohét nje hère dhé pastaj 3 hère « *Krishti u-ngjall* », pastaj Degjimi dhé Shkurtorja.

Ne vent te « *Shent Pérendi* », thuhét :

Sa u-pagezuat me Krishtin, mé Krishtin u-véshte. Alleluia.

APOSTULL

Kjô eshte dita qe bëri Zoti; lé te ngazellohémi dhé lé te dejréjme ne tê.

Rreféni Zotin, sé esht i mire, sé perdellim' i tij mban per jéte.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

Fialen é pare, ô Théofil, é bëra per te gjitha sa nisi Jésuj te bëje é te mesoje gjér m'atê dite qe u-shéstjua, passi mé anen é Shpirtit Shénjt u lâ porosira Apostujvé qe pat zgjédhur. Te cilevé u dehtëu dhé vétén é tij te gjalle passi pesoj mé shume shenja, dyké u-dukur ner tà per dyzét dite, dhé dyké u folur per punet é mbréterise se Pérendise. Dhé dyké qéne mblédhur, i porositi mos ndahén nga Jérusalémi, po te présin zotimin é Atit qe

degjuat préj méjé. Sé Joani pagezozj mé uje, po ju do te pagezohéni mé Shpirt Shénjt jo pas shume ditsh qe sot. Kur u-mblodhe pra, é pyésnin, dyké thène : « Zot, valle me ketê kohe do t' i réstorosh mbréterine Israélit ? » Dhé ay u tha : « Nuk eshte puna juaj te njihni koherat é motét qe i ka vène Ati ne potére te tij. Po do te mérrni fuqi, kur te vije Shpirti Shénjt mi ju; dhé do t' me jini deshmore ne Jérusalém dhé ne tère Judéne dhé Samarine, édhé gjér ne funt te dhéut. »

UNGJILL. — PAS JOANIT.

Ne kryé ishtë Fiala, dhé Fiala ishtë mé Pérendine, édhé Fjala ishtë Pérendi. Kjô ishtë ne kryé mé Pérendine: te gjitha u-bène mé anen é saj; dhé pa até nuk u-bê asnje gjê nga ç' qè bère. Ne tê ishtë jéte, édhé jéta ishtë drita é njéresvé. Edhé drita ndrit n'érresire, dhé érresira nuk é kupetozj. Qé nje njéri i derguar nga Pérendia, emeri i te cilit qé Joan. Ky ardhi per deshmim, qe te deshmoje per Driten, qe te bésojne te gjithë mé anen é tij. Ay nuk ishtë Drita, po qé per te deshmuar per Driten. Ishtë Drita é vertéte, qe ndrit ç'dô njéri qe vjén ne bote. Ishtë ne bote, edhé bota u-bê mé anen é tij, édhé bota nuk é njohu. Ardhi ner te tijte, édhé te tijte nuk é pritne. Po sá é pritne, u dha potére te bëshen bij Pérendié atyrévé qe bésojne me émerin é tij. Te cilet nuke lintne préj gjakrash, as préj deshiré mishi as préj deshiré burri, po préj Pérendié. Edhé Fiala u-bê mish édhé ndenji nder né (dhé é pame lavdin' é tij, posi lavdi te vétémindurit préj Atit), plot mé hir é mé te vertéte. Joani deshmon per tê dhé thirri, dyké thène : « Ky eshte ay per te cilin' thashe : Ay qe vjén pas méjé eshte më i math sé une, sépsé ishtë perpara méjé ». Dhé préj plotesise se tij né te gjithë muarme, dhé hir per hir. Sé ligja u-dha préj Moisiut, po hiri dhé é vertéta ardhi préj Jésu Krishtit.

Pastaj thuhét Mësh' é Gojartit.

Ne « *Véçan Têreshênjten* » thuhét : « *Engjelli i therristé Hirplotés* »

Kungatoré.

Kungoni préj Trupit te Krishtit, ngjeroni préj burimit te pavdékshim.

Ne vent te « *Pame driten* » dhé te « *Emer' i Zotit qofte i békuar* » thuhét : « *Krishti u-ngjall* ».

Pas Urimit prapa Ambonit, « *Krishti u-ngjall* » pa zê tri hére. Pastaj kendohét préj Priftit ky :

URIM

I SHEN JOAN GOJARTIT.

Cilidô piétos dhé hyjdashes lé te gezoje ketê panair te mire dhé te shkelqyér. Cilidô sherbetor mirenjohes lé te hyje i gezuar té gazi i te Zott. Ay qe u-mundua, dyké krëshmuar, lé te gezoje tani dénarin. Ay qe punoj qe préj ores se pare, lé te prése sot çpagimin é dréjte. Ay qe ardhi pas se trétes lé te krémterojé mé gjithé zemer. Ay qe arriu pas se gjashttes lé te mos dyshoje asfaré; sé nuke peson asnje dêm. Ay qe vonoj gjér me te nëntten, lé t'afrohét pa hëzituat faré. Dhé ay qe arriu vétém me te njembedhiétten, lé te mos trembét nga vonimi. Sé Zoti, dyké qêne i zemerdhempshur, prêt te funtmin sikunder dhé te parin, çloth até te se njembedhiéttes, si até qe punoj qe préj se pares. Dhé te funtmin é perdellén dhé te parin é sheron; dhé atí i jép dhé ketí i fal; dhé punet i prêt dhé mendimin é pelqén; dhé vépren é ndéron dhé qellimin é levdon. Hyni pra te gjithé té gazi i Zotit tone; dhé te pare dhé te dyte, gezoni rogen. Te pasur dhé te varfer, vallézoni mé njêrjatrín; te perkoeshme dhé te ngathet, ndéroni ditén; sa krëshmuat dhé sa nuk krëshmuat, defréni sot. Tryésa eshte plot, hani qe te gjithé. Viçi eshte i shume, asnje lé te mos dale uret. Te gjithé, gezojéni darken é

bésés; te gjithë, gezojëni pasurin' é miresise. Asnje lé te mos vajtoje per varferi; sé u-çfaq mbréteria é perbashkmé. Asnje lé te mos qaje per fajé; sé ndjésa lindi nga varri. Asnje lé te mos kéte frike nga vdékja; sé na çliroj vdékja é Shpetimtarit. E shuajti, kur permbahéj préj tij. E plaçkoj Férrin ay qe zbriti ne Férr. E hidheroj, kur ngjeroj mishin é tij; dhé ketê dyké pareshikuar Isaia, thirri : Férrin u-hidherua, tha, kur te hasi poshte. U-hidherua, sé u-abolit. U-hidherua, sé u-perqësh. U-hidherua, sé vdiq. U-hidherua, sé u-rrezua. U-hidherua, sé u-burgos. Priti trup dhé gjéti Pérendi. Priti dhé, é hasi qiéll. Mori atê qe shikonté dhé ra ngaha nuke shikonté. Kú eshte gjêmbi yt, ô vdékjé? Ku eshte mburrja joté, ô Férr? U-ngjall Krishti dhé ti u-hodhé poshte. U-ngjall Krishti dhé rane démonet. U-ngjall Krishti dhé gezohén Engjejte. U-ngjall Krishti dhé jéta qytéterohét. U-ngjall Krishti dhé asnje i vdékur s' mbéti ne varr. Sé Krishti, dyké u-ngjallur se vdékuresh, u-trégua kulloshtira é te fiéturvé. E atí eshte lavdia dhé potéra ne jéte te jétevé. Amen.

Dhé mé nje hère Kendohét TROPAR' I SHENJTIT, T. T. IV :

Hir' i gojes s' até qe shkelqén si pishtar ndriçoj gjithesine, thésaré mosargjentdashjéjé pertogesoje per boten, lartesiren é perunjesise na trégoj. Po, siç na areson mé fialet é tua, ô Ate Joan Gojarte, nermjêto té Krishti Pérendia te shpetohén shpirtét tona.

MBREMESORJA É MADHÉ

Me 10 te mengjézit Prifterijte vishén mé robot é tyré më te mira dhé shétitin ne fshat a ne qytét, dyké kendar ngadalé « *Krishti u-ngjall* ».

Passi hyjne ne Kische dhé passi békon Prifti, kendohét « *Krishti u-ngjall* » tri ne Alltar dhé 6 hère préj Vallévé mé Vargjéte dhé pastaj nje hère tjater ne Alltar.

Pastaj Litani é Madhé dhé mé nje hère Thirrtorét me T. II.

Pastaj thuhén 6 Vargezimét Ngjalljésoré te para te mbrêmes te T. II. Pastaj :

Lavdi. — Dyké kenduar hymnin shpetimtar, lé te méllodisim mé goje. Eni te gjithë te biém ner kêmbe té shtepi' é Zotit, dyké thêne : Ti qe u-kryqesové mi dru, dhé u-ngjallé se vdékuresh dhé jé té gjir' i Atit, kij meshire per mekatét tona.

Tani. — Shkoj hiéja é ligjes...

Hyrja mé Ungjillin. « *Drite gazmoré* ».

Parevark.

Cila Pérendi esht aq' é madhé sa Pérendia jone?
Ti jé Pérendi' é vétém qe bèn çudira.

Pastaj thuhét me shume gjuhe, si pas zakonit, ky

UNGJILL. — PAS JOANIT.

Si u-ngrys até dite, qe ish é par' é Javes, dhé dyké qêne dyérte te mbyllura, atjé ku ishin mblédhur dishépujte, nga frik' é Judéjvé, ardhi Jésuj dhé qendroj ne mést é u thote : « Paqe me ju ». Dhé si tha ketê, u deftéu duarte dhé brinjen é tij. U-gezuan pra dishépujte kur pane Zotin. U tha pra Jésuj perserì : « Paqe me ju ; sikunder me ka derguar Ati, dhé une ju dergoj juvé. » Dhé si tha ketê, fryri dhé u thote : « Mérrni Shpirtin Shénjt ; kujvé t' u falni mekatét, u jane falur ; kujvé t' ua mbani, jane te mbajtura ». Po Thomaj, nje préj te Dymbedhiétevé, qe thuhéj Binjak, nuk ish mé atà, kur ardhi Jésuj. I thoshin pra dishépujt é tjére : « E pame Zotin ». Po ay u tha : « Ne mos pafsha ne duar te tij shtypin é péronavé, dhé te vê gishtin t' im té shtypi i péronavé, dhé te vê doren t' imé té brinj' é tij, nuke do te bésoj ».

Pastaj Litanì é Gjére, « *Vlérésôna, ô Zot* », « *Lé t' ia mbarojme lutjén tone* » étj. Pas Thirrjés, kendojme Pasvargun é pare te

Tingellit II, dhé pastaj « *Pashke hiéroré* », Lavdi é Tani : « *Dit' é Ngjalljés* », « *Krishti u-ngjall* » tri hére dhé Perleshim.

JAV' É PASHKES

Tère Javen é Pashkes béhét Sherbésa é Pashkes se Madhé, dhé kendohén mé radhe Vargezimét Ngjalljésoré te Tingejvé, te Hènen T. II, te Marten T. III, dhé keshtú tutjé.

Te Premtén é Javes se Pashkes kendohét bashke dhé SHERBÉSA É BURIMIT JÉTEPRURES.

E DIÉLA É SHEN THOMAJT

NE MBRËMESORÉ

Ne Thirrtorét thuhén ketô Vargezimé, dyké persedytur kater te parat, me T. I :

Dyké qêne dyérte te mbyllura, kur ishin mblédhur Dishépujte, hyré béfas, ô Jésu i têrefuqishim, Pérendia jone; dhé, si qendrové ne mést, u dhè paqen dhé i mbushé mé Shpirt Shénjt; dhé i porosité te présin é te mos ndahén nga Jérusalémi gjér sa te vishén mé fuqine se larti. Perandaj po te therrésim : Ndriçimi, ngjallja dhé paqa jone, lavdi me ty.

Téte dite pas Ngjalljés s' até, ô Zot, u-duké ner Dishépujt é tu ne vent ku qêne mblédhur dhé u thirrè : Paqe me ju. Dishépullit qe s' bésonté i trégové duarte dhé brinjen é panjollshmé dhé ay u-bint é te therristé : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdi me ty.

Thomaj, qe thuhéj Binjak, nuk ish mé tà, kur hyré, ô Krisht, dyké qêne dyérte te mbyllura, dhé perandaj nuk i bésonté atô qe i thane. Po ti, ô i Mire, nuke hézitové t' i trégosh brinjen tëndé te pacinuar dhé plaget é duarvé dhé te kêmbevé. Dhé ay, si préku dhé pâ, te njohu qe jé Pérendi jo é çvëshur dhé njéri jo i vogel, dhé therristé : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdi me ty.

Kur Dishépujte qêne te trembur, me ditén é tétte, u qendroj perpara Shpetimtari atjé ku qêne mblédhur; dhé, si u dha paqen, i thirri Thomajt : Eja, ô Apostull, prék pellëmbet me te cilat mberthyén péronat. Oh, mosbésim i mire i Thomajt ! Solli ne njohjé zemrat é

bésnikevé! Dhé ay mé frike thirri : Zoti im dhé Pérendia imé.

T. II. — Pas Ngjalljés s'até, ô Zot, kur qëne mblédhur Dishépujt é tu dhé dyérte mbyllur, qendrové ne mést dhé u falé paqen. Dhé si u-bint Thomaj mé pamjén é duarvé dhé te brinjes s'até, te rreféu Zot dhé Pérendi, qe shpeton atà qe bésojne me ty, ô njéridashes.

T. II. — Dyké qëne dyérte te mbyllura, qendroj Jésuj perpara Dishépujvé dhé u jépté kuraje dhé paqe; pastaj i thote Thomajt : Persé nuke béson qe u-ngjalla se vdékuresh? Sill ketu doren tëndé dhé é vèr ne brinjen t'imé dhé shikô; sé nga mosbésimi yt, mesuan te gjithë Pesimét dhé Ngjalljén dhé therrésin mé ty : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdì me ty.

Lavdì é Tani. — *T. T. II.* — Dyké qëne dyérte mbyllur, ô Krisht, qendrové perpara Dishépujvé. Ahéré Thomaj ékonomerisht nuk u-gjént mé tà; sé thoshtë : Nuke do te bésoj, ne mos é pafsha dhé une Zotin. Dua te shoh brinjen, ngaha dolli gjaku, uja dhé pagezimi; te shoh plagen, préj se ciles u-sherua plaga é madhé, njériu; te shoh qe nuk ish hié, po mish dhé éshtera. O Zot, qe shkélé vdékjén dhé lajmerové Thomane, lavdì me ty.

Pasvargjé. — *T. IV.*

O çudì é mahniçimé! Mos-bésimi lindi bése te shigurte; sé Thomaj tha : Ne mos pafsha, nuke do te bésoj. Dhé passi préku brinjen, théologonté per até qe u-misherua, qe ish véte i Bir' i Pérendise; njohu qe pesoj truperisht; é leçiti Pérendin' é ngjallur, dhé thirri mé zé te shkelqyér : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdì me ty.

Vark. — *Levdô Zotin, ô Jérusalém; lavderô Pérendine tëndé, ô Sion.*

O çudì é mahniçimé! Bari préku ziarrin dhé shpetoj; sé Thomaj vuri doren té brinja é ziarrte é Pérendise Jésu

Krisht, dhé nuk u-dog nga prékja; sé mos-bésimin é shpirtit é kthéu ne bése te nxhéte dhé thirri théllazi préj shpirtit : Ti jé Zoti im dhé Pérendia, qe u-ngjallé se vdékuresh. Lavdi me ty.

Vark. — Sé forcoj llozét é dyérvé te tua.

O çudi é mahniçimé ! Joani rà me kraherorin é Fiales, dhé Thomaj u-vléresua te préke brinjen; njêri nxiér s'andéjmi nje théllesire te tmérruar Théologié, dhé tjatri u-vléresua te na inicioje ékonomine; sé trégon faqéza provat é Ngajlljes s' até, dyké thirur : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdi me ty.

Lavdi é Tanì. — T. T. I. — O njéridashes, shumica é meshiravé te tua esht é madhé dhé é paimaginuârshmé; sé paté zemren é gjére, kur shuplakoheshé préj Judéjvé, kur prékeshé préj Apostullit, dhé kur ngiteshé préj kundreshtarevé te tu. Si u-misherové? Si u-kryqesové, ô i pamekateshme? Po jép-na ment, si Thomajt, qe te te therrésim : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdi me ty.

Perleshoré. — T. i Rênde.

Dyké qêne varri i shiluar, ô jéte, lindé préj varrit, ô Krisht Pérendi; dhé dyké qêne dyérte mbyllur, u qendrové perpara Apostujvé, ô ngjallja é te gjithevé, dhé perserité ner né fryme te dréjte mé anen é tyré, pas perdellimit têt te math (*tri hère*).

NE MENGJËS

Ndenjcsoré.

T. I. — Pas « Tu lithu sfragisthéntos ». — Nga frika é Judéjvé kur qéne fshéhur Dishépujte, te permlédhur ne Sion, ô i mire, hyré ner tà, dhé dyké qêne dyérte mbyllur, qendrové ne més te tyré dhé i gezové; dhé u trégové duarte dhé plaget é brinjes s' até se panjolleshmé, dhé

Dishépullit qe s' bésonté i thè : Sill doren dhé shih qe une véte jam, qe pesova per ty (*dy hére*).

T. II. — *Pas « Ton tafon su Sotir ».* — O jéte, u qendron, kur qéne dyérte mbyllur, dhé brinjen u trégon Apostujvé te gjithë, édhé këmbet édhé duarte, dhé Ngjalljén tëndé préj varrit u provon, ô Krisht; mirpo Thomaj nuk ndodhëj; perandaj pra thosh : Ne mos é pafsha dhé une, fialevé tuaja s' u bindém (*dy hére*).

Gjith' ashtu. — Brinjen si m' a pé, édhé çpojtjët préj péronjash, Thoma, persé s' béson Ngjalljén t' imé te vertéte? i thoshtë Zoti Jésu Krisht, kur u-ngjall préj se vdékuresh, édhé u-fanés ner Apostujte pa tréguar; dhé Binjaku u-bint dhé i therristé Krijétarit : Pérendia imé dhé Zot (*dy hére*).

« *Qe préj dialerise s' imé* », pastaj :

Parevark.

Levdô Zotin, ô Jérusalém; lavderô Pérendine tëndé, ô Sion.

Vark. — Sé forcoj llozét é dyérvé te tua.

Shkurtoré. — *T. T. IV.*

Mé doren kuriozé Thomaj nxoniti brinjen tëndé jétefalesé, ô Krisht Pérendi; sé, kur hyré dyké qéne dyérte mbyllur, therristé mé Apostujt é tjére : Ti jé Zoti im dhé Pérendia imé.

Shpia.

Cili é ruajti ahéré pellëmben é Dishépullit te pashkrire, kur iu-afrua brinjes se ziarrte se Zotit? Cili i dha quxim dhé mundi te préke ashte te flageshmé? Pa dyshim ajó qe u-prék; sé po te mos i jépté brinja fuqì dores se balte, si do te muntté te prékté pesimét qe tronditne qiéllin é dhéne? Ky hir iu-dha Thomajt qe t'a préke dhé t' i therrése Krishtit : Ti jé Zoti im dhé Pérendia imé.

Synaksari.

Gjithe sot, te Diëlen é Dyle pas Pashkes, krémteroÿme inaugurateen é Ngjalljës se Krishtit, dhé prékjén é Apostullit Shen Thoma.

Ne mos é ndalon klyç 'i barkut a i varrit,

Qysh do t'a ndaloje sulmin tënt, ô Shpetimtar, klyç prëj dyërsh ?

Mé nermjëtímét é Apostullit tënt Thoma, ô Krisht Pérendia jone, meshiró-na. Amen.

ZBRITESORÉ te Pashkes. — Ungjilli Mengjézor I.

Dergimesoré. — T. III.

Si nxonité mé doren tëndé plaget é trupit t'im, ô Thoma, mos kij dyshim qe u-plagosa per ty, jij me nje mendjë mé Dishépujte dhé Pérendin' é gjalle leçit (*dy hére*).

Sot bié ére prenvére dhé vallézon kriés' é ré; sot zgjidhén klyçét é dyérvé dhé te pabésise se mikut Thoma qe therrét : Zot dhé Pérendia imé.

Lavderimé. — T. I.

Pas « Panéfimi Martirés ». — Pas Ngjalljës s' até se tmérreshmé prëj varrit, Jétedhënes, siç nuk i zgjidhé shilat, ô Krisht, te varrit tent, ashtu, dyké qëne dyërte te mbyllura, hyré té Apostujt é tû dhé i gezové, dhé u falé Shpirtin tënt te drëjte nga perdellimi i paaneshme (*dy hére*).

Thoma Binjaku nuke qé bashke mé até, ô Zot, kur u-duké ner Dishépujte; andaj pra nuke bésoj Ngjalljén tëndé, édhé shokevé u thosh : Ne mos vënça gishtin t' im permi brinjen é tij dhé ne çpojtjét é péronavé, nuke do besoj qe u-ngjall se vdékuresh.

Prék-me sikunder desheron, Krishti i tha Thomajt, vër doren tëndé édhé njih qe kam éshtera, édhé trup te dhëshme, dhé i pabése mos u-bêj, dhé ketô dhé te tjérat i bésô. Dhé ay thirri : Pérendia édhé Zoti im ti ké qëne; lavdì Ngjalljës s' até.

Lavdì. — T. T. II. — Tète dite pas Ngjalljës s' até,

ô Jésu Mbrét, Fial' é vétemlindur é Atit, u-duké ner Dishépujt é tû, dyké qêne dyérte mbyllur, dhé u falé paqen tëndé, dhé Dishépullit qe nuke bésonté i trégové shenjat. Eja, prék-m' i duarte dhé kêmbet dhé brinjen é amëshuar. Dhé ay u-bint é te therristé : Zoti im dhé Pérendia imé, lavdi me ty.

NE MÉSHE

Hyrtoré é Pashkes, Perleshoré é Shen Thomajt, dhé Shkurtoré é Pashkes.

APOSTULL

I math esthe Zoti yne dhé é madhé juqi' é tij.

Lavderojéni Zotin, sé esht i mire.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

M'atô dite, u-bêne shume shenja dhé çudira ne popull mé duart é Apostujvé; (Dhé ishin te gjithë ne porke te Salomonit. Dhé nga te tiéret asnje s' kuxonté t' i ngisté; po i madheshonté populli. Dhé më téper shtoheshin shumica burrash é grash, qe i bésonin Zotit); sa nxirnin jashte neper shëshét te semuret dhé i vinin ner shtraté dhé shtrésa qe, dyké ardhur Piétrit, t' i bjére hij' é tij dobaré nonjejt préj syrësh. Dhé po mblidhëj ne Jérusalem dhé shumica é qytétévé rrotull, dyké siëlle te semure dhé te ngare préj frymerash te ndyra, te cilet sheroheshin te gjithë. Dhé u-ngrit Kryéprifti dhé gjith' atà qe ishin mé tê, qe ishin nga hérésia é Sadukéjvé dhé u-mbushne mé zemerim dhé vune duarte mi Apostujte dhé i çuan ne burk te boteshme. Po Engjelli i Zotit hapi naten dyért é burgut dhé i nxori dhé u tha: Shkoni dhé qendroni é flisni ne shenteroré gjithë fialet é kesaj jété.

UNGJILL. — PAS JOANIT.

Si u-ngrys atê dite, qe ish é par' é Javes... (*Shih Ungjillin Menqjézor IX*).

Ne « *Véçan Têreshênjten* » thuhét :

T. I. — Ty, lampaden é ndriçimé dhé nênen é Pérendise, lavdin' é perzilishmé dhé mê te larten sé gjithë kriésat, mé hymné te madheshtojme.

Kungatoré.

Levdô Zotin, ô Jérusalém, dhé lavderô Pérendine têndé, ô Sion.

Ne vent te « Pame driten » : « Krishti u-ngjall », é cila thuhét gjér me Shéstjé.

E DIÉLA É MYRREPRURSÉVÉ

NE MBREMESORÉ

Thirrtoré.

Thuhén shtate Vargezimét é Tingellit II, dhé pastaj ketô tri te Vétézëshmé, T. II :

Grate Myrrepruresé qe mé-nate muare aroma dhé zune varrin é Zotit; dhé, dyké gjétur atô qe nuke shprésenin, te çuditura po mendoheshin per çvendosjén é gurit dhé thoshin mé njêrjatren : Kú jane shilat é varrit? Kú eshte kustodia é Pilatit dhé shigurimi i sakte? Dhé nje Engjell qe vétetinté u-bê lajmeronjes i Gravé qe nuke dinin, dyké u thêne : Persé kerkoni mé vajtimé te gjallin, qe i dha jéte gjindjés se njéresvé? U-ngjall Krishti Pérendia jone préj se vdékuresh, si i têrefuqishme, dhé na fali te gjithévê paprishjé dhé jéte, ndrìchim dhé perdellimin é math.

Persé trazoni myrrat mé loté, ô Dishépullésa? Guri eshte rugullizur, varri eshte zbrazur; shihni prishjén qe u-shkél préj jétes, shilat qe deshmojne kjarisht, dhé ruajtesit é te pabindurvé qe fléne tmérrerisht. Njérezit shpetuan mé trupin é Pérendise; Férrì vajton; réntni mé gas dhé u thoni Apostujvé : Krishti qe vrau vdékjén, i parelinduri i te vdékurvé, po ju prêt ne Galilé.

Myrrepruresét, dyké menguar qe mé-nate, zune varrin têt mé shpéjtim, dhé te kerkonin, ô Krisht, per te myrosur Trupin têt te pacinuar; dhé, si degjuan fialet é Engjellit, u lajmeronin Apostujvé symbolé gazmoré : Qe u-ngjall kryétari i shpetimit tone, dyké plaç-

kuar vdékjén dhé dyké i dhuruar botes jéten é améshuar dhé perdellimin é math.

Lavdi. — T. T. II. — Grate Myrrepruresé zune varrin têt dhé, kur pane shilat é varrit dhé nuke gjétne Trupin têt te pacinuar, dyké vajtuar ardhe mé nxitim, dyké thêne : Cili vodhi shprésen tone? Cili mori nje te vdékur te çvêshur, te smyrnosur, qe ish vétem per nênen ngushellim? Oh! qysh vdiq ay qe ngjalli te vdékur? Qysh u-varros ay qe plaçkoj Férrin? Po ngjallu, ô Shpetimtar, mé potéren é véte i triditeshme, sikunder thé, dhé shpetô shpirtét tona.

Tani. — T. II. — Shkoj hiéja é Ligjes...

PASVARGJÉ : Thuhét Pasvargu i pare i Tingellit II dhé pastaj « Pashke hiéroré » mé Vargjét.

LAVDI. — T. T. I : « Ty, qe vishësh mé driten si robe ... » (*Shih ne Triod, pas Orevé te se Premtés se Madhé, ne funt te Mbrêmesorés*).

TANI : « Dit' é Ngjallés... »

Perleshoré. — T. II.

Kur zbrité té vdékja...

Lavdi. — Bujari Joséf, dyké zbritur préj drurit Trupin têt te pacinuar, é peshtolli mé pelhure te paqmé dhé mé aroma dhé mé vajtimé é vuri ne nje varr te ri; po u-ngjallé pas tri ditsh, ô Zot, dhé i falé botes perdellimin é math.

Tani. — Gravé Myrrepruresé, dyké qendruar prane varrit, Engjelli u therristé : Myrrat u kane hié te vdékshimvé, po Krishti u-trégua i huaj per prishjén. Therriisni pra : U-ngjall Zoti dhé i fali botes perdellimin é mat h

NE MENGJÉS

Ndjenjesoré. — T. II.

Dyké mos ndaluar te shilohét gur' i varrit, u falé te gjithevé shkêmbin é béses, passi u-ngjallé. O Zot, lavdi me ty.

Lavdi. — Pa zbrazur gjirin é pacinuar me te lartat, dénjobé varrim dhé ngjalljé per te gjithë. O Zot, lavdi me ty.

Tani. — Te gjitha permi méjtim, te gjitha te permilavdishimé myshtëret é tua, ô Hyjlindesé; é shiluar mé qashterì dhé é ruajtur mé virgjerì, u-njohé Mëm' é vertéte, dyké lindur Pérendin' é vertéte. Ati iu-lut te shpetohén shpirtét tona.

Myrrepruresét, si ardhe qe mé-nate dhé si pane varrin te zbrazet, u thoshin Apostujvé : I potéreshmi rrezoj prishjén, dhé atà qe ishin ne Férr i rrembéu préj vargojvé; leçitni pra shéshit : Qe u-ngjall Krishti Pérendi, dhé na fali perdellimin é math.

Lavdi. — Grate, dyké prure myrrat é varrimit tént, ardhe ne varr qe mé-nate fshéhurazi, sé kishin frike nga paturpesia é Judéjvé, dhé pareshikonin shigurimin é ushtarevé; po natyra é dobet é mundi trimerine, sé qellimi i mire i pelqéu Pérendise; therrisnin pra mé gezim : Ngjallu, ô Zot, ndihmô-na, dhé çperblé-na per émerin tént.

Tani. — E permilavderuar jé, ô Hyjlindesé Virgjeréshe, te hymnojme; sé mé anen é Kryqit te Birit tént u-thyé Férrì dhé vdékja vdiq; né te vdékurit u-ngjallme dhé u-vlérésuam per jéten; muarme Parajsen, gezimin é viéter. Perandaj, dyké perhiruar, é lavderojme Krishtin, Pérendine tone, si te fuqishme dhé si te vétemin meshi-replot.

Pastaj Békimtorét, Degjimi dhé Shkallésat é Tingellit II.

Shkurtoré. — T. II.

Dyké u thêne Myrreprursévé « Gezhohuni », pushové vajtimin é Stergjyshés Eve mé Ngjalljén téndé, ô Krisht Pérendi; dhé u urdherové t' u leçitin Apostujvé te tu : Shpetimtari u-ngrit préj varrit.

Shpia.

Myrrepruresét, kur shkonin té varri yt, ô Shpetimtar, perplikoheshin mé vété ne mendjé dhé thoshin : Cili do te na rugullize gurin préj varrit? Dhé, kur ngritne syte perpiéte, shohin qe guri ish i rugullizur; dhé po çuditeshin per fytyren dhé stolin' é Engjellit, dhé permblidheshin mé tmérr dhé mendoeshin te ikin; dhé dialoshi ahéré u thirri : Mos kini frike; ay qe kerkoni u-ngjall; éni te shikoni vendin, ku dérgjéj trup' i Jésujt; po shkoni shpéjt dhé u lajmeroni Apostujvé : Shpetimtari u-ngrit préj varrit.

Synaksari.

Gjithe sot, te Tréten te Diële pas Pashkes, krémterojme te krémtén é Gravé Myrrepruresé te shénjta; dhé perkujtojme Joséfin préj Arimathise dhé Nikodémin, dishépuj te fshéhte, qe varrosne Zotin.

Myrrepruresét i siëllin myrra Krishtit,

Dhé une ketyrévé u siëll per myrre hymné.

Mé nermjétimét é Myrreprursévé te shénjta, ô Pérendî, meshirô-na. Amen.

ZBRITESORÉ te Pashkes.

UNGJILL MENGJÉZOR IV.

Dergimesoré. — T. II.

Mé pare é Pashkes, pastaj dy hére kjô :

O Gra, degjoni lajme gazmoré : Dyké shkélur Férrin shtyran, é ngrita boten nga prishja; réntni, u thoni miqvé te mi ungjillezimét; sé dua t' a ndriçoje gazi kriatyren t' imé andéj ngaha ardhi hidherimi.

Lavderimé.

Thuhén 4 Vargezimé te Tingellit II, dhé pastaj « *Pashke hiéroré* » mé Vargjé. LAVDI, Mengjézorja II, TANI « *Di' é Ngjalljés* ».

NE MÉSHE

Hyrtoré é Pashkes, tri Perleshorét é Myrreprursévé, Shkurtoré é Pashkes.

APOSTULL

Zoti eshte fuqia imé dhé kënga imé.

Zoti dyké munduar me aresoj.

Kendimi prëj Aktévë t' Apostujvé.

M'atô dite, si u-shumuan Dishépujte, u-bê nje qarjë é Hélénistevé kunder Hébréjvé, sé lihëshin me nj' ane te véat é tyré ne sherbim te perditeshme. Dhé te Dymbedhjéttet ftuan shumicen é dishépujvé dhé u thane: « Nuk esht é pelqyér qe né te lëme fialen é Pérendise dhé te sherbéjme ner tryésat. Shikoni pra, vellézer, shtate véta prëj jush, per te cilet te jipét deshmi é mire, plot mé Shpirt Shénjt, te cilet t' i vendosim mi keté névoje, dhé né te shikojme faljén dhé sherbésen é fiales ». Dhé u-pelqyé fiala perpara tëre shumices; dhé zgjodhe Stéfanin, burre plot mé bése dhé Shpirt Shénjt, dhé Filipin, dhé Prokorin, dhé Nikanorin, dhé Timonin, dhé Parménane, dhé Nikollen, nje prosélit Antiokas, te cilet i nxuare perpara Apostujvé; dhé passi u-fale, vune duarte mi tà. Dhé fiala é Pérendise shtohéj, dhé shumohéj numuri i dishépujvé ne Jérusalém fort; dhé shume gjindjë prëj priftervé é degjonin bésen.

UNGJILL. — PAS MARKUT.

M' atê kohe, Joséfi prëj Arimathise (i cili ishtë dishépull i Jésujt, po i fshéhur nga frik' é Judéjvé) iu-lut Pilatit qe te ngrére trupin é Jésujt; dhé Pilati i permétoj. Ardhi pra dhé ngriti trupin é Jésujt. Ardhi dhé Nikodémi (ay qe pat ardhur perpara té Jésuj naten) édhé pruri nje perziérjë smyrné dhé allojë, sidonja nje qint litra. Muare pra trupin é Jésujt, dhé é peshtuale mé pelhura bashke mé aromat, sikunder eshte zakon te varrosin Judéjte. Edhé ne vent, ku u-kryqesua, ishtë nje kopsht, dhé ne kopsht nje varr i ri, ne te cilin nuk ishtë vëne kurre asnonje. Atjë pra é vune Jésune, per te Premtén é

Judéjvé, sé varri ish afer. Dhé si shkoj é Shtuna, Maria Madaléna dhé Mari' é Jakobit dhé Saloma bléne aroma qe te vijne é te lyéjne Jésune. Dhé shume mé-nate, te paren ditén é Javes, vijne ne varr, me te lindur diélli, dhé thoshin mé vétén é tyré : « Cili do te na é rugullize gurin préj déres se varrit? » Sé ish fort i math. Dhé kur hyjtin ne varr, pane nje dialosh qe rrinté me te diathte, te véshur mé stolì te bardhe, dhé u-çuditne. Dhé ay u thote : « Mos u-çuditni. Kerkoni Jésune Nazaréasin te kryquesuarin. U-ngjall, nuk eshte ketu, já vendi ku é vune. Po éceni dhé u thoni dishépujvé te tij dhé Piétrit qe shkon perpara jush ne Galilé; atjé do t'a shikoni, sikunder ju tha »: Dhé dualle shpéjt, dhé ikne nga varri; dhé i kish zéne trembjé dhé habitjé, dhé asnjériu s' i thane gjê; sé kishin frike.

Ne « *Véçan Têreshénjten* » thuhét : « *Engjelli i therristé* ». Kungatoré thuhét ajò é Pashkes.

E DIÉLA É ULOKUT

NE MBRËMESORÉ

Thirrtoré.

Thuhén 7 Vargezimé te Tingellit III, dhé ketô te dyja, nga te cilat é para persedytét :

T. I. — O Krisht meshireplot, qe gatové njérine mé pellêmben têndé te pacinuar, ardhé te sherosh te semuret. Ulokun ne Liqén te Dhênvé é ngrité mé fialen têndé, sherové dhembjén é Gjakrjédhures, meshirové te bijen é Kananéanés qe ngitéj, dhé nuke méprizové lypjén é Qénturionit. Perandaj pra therrésim : O Zot i têrefuqishim, lavdì me ty.

Uloku, qe ishtë si i vdékur i pavarrosur, kur te pâ, thirri : Kij meshire per mua, ô Zot, sé shtrati m' u-bê varr. Ç' fitim kam nga jéta? Liqéni i Dhênvé s' me hyn ne pune, sé s' kam njéri qe te me hédhe brenda, kur trubullohén ujerat; po vij té ty, burim' i sherimévé, qe te therrés dhé une mé te gjithë : O Zot i têrefuqishim, lavdì me ty.

Lavdì. — *T. T. I.* — U-ngjit Jésuj ne Jérusalém té Liqéni i Dhênvé, qe thuhéj Hébraisht Béthésdà, qe kish pése kamaré; sé ner tô ishtë shtrire shumica é te semurevé. Sé nje Engjell i Pérendise vinté me nje kohe dhé é trubullonté, dhé u falté sherim atyrévé qe hynin mé bése. Dhé pâ Zoti nje njéri qe kish atjé shume kohe, dhé i thote : A dô te bêhësh i shendoshe? I semuri u-pergjéq : Zot, s' kam njéri qe te me shtjére ne liqén, kur trubullohét uja. Shpéndova tère plêngun t' im ner

miéke, dhé nuk u-vléresova te gjéj shpetim. Po miéku i shpirtévé dhé i trupévé i thote : Ngrér shtratin têt dhé barit, dyké leçitur fuqine t' imé, dhé perdellimin é math ner anet é dhéut.

Tanì. — *T. III. Hyjlindesoré.* — Si te mos admirojme lindjén tëndé...

Pasvargjé.

Thuhét më pare Pasvargu i pare i Tingellit III dhé pastaj « *Pashke hiéroré* » mé Vargjét.

Lavdì. — *T. T. IV.* — Ne Porke te Salomonit, atjé ishtë shtrire shumic' é te semurevé; dhé, kur méseronté é Krémntja, gjéti Jésuj te shtrire nje ulok tridhjét' é téte viétsh. I thote mé zê zoteror : A dô te bêhësh i shendoshe? I semuri u-pergjéq : Zot, s' kam njéri qe te me hédhe ne liqén, kur trubullohét uja. Dhé ay i thote : Ngrér shtratin têt; shih, u-béré i shendoshe, mos mekatô më. Mé nermjétimét é Hyjlindesés, ô Zot, dergô-na perdellimin é math.

Tanì. — Dit' é Ngjalljés...

Perleshoré dhé Hyjlindesoré é Tingellit III.

NE MENGJÉS

Ndenjesoré, Degjim, dhé Shkallésa te Tingellit III.

Shkurtoré. — *T. III.*

Shpirtin t' im, ô Zot, te ulokesuar ne çfaredô mekaté édhé vépra te paudha, ngréré mé urdherin têt te pérendishme, siç ngrité qe-moti Ulokun, qe te therrés i shpetuar : O Krisht meshireplot, lavdì potéres s' até.

Shpia.

O Jésu Pérendì, qe permban mé grushtin é dores s' até anet é dhéut, i bashkepaniseshim mé Atin, dhé qe zoteron mi te gjitha mé Shpirtin Shénjt, u-duké

truperisht, dhé sherové semundjë, dbové pesimé, ndriçové te vérber, dhé Ulokun ti é ngrité mé fiale te pérendishmé, dhé i urdherové te barése mé nje héré, é te ngrére mi supét shtratin qe é mbajti; perandaj pra te gjithë perhymnojme mé të dhé therrésim : O Krisht meshireplot, lavdì potéres s' até.

Synaksar.

Gjithe sot, te Katerten te Diële pas Pashkes, perkujtojme çudin' é Ulokut.

Fiala é Krishtit eshte shendët per te semurin.

Keshtu pra sheroj Ulokun fial' é tija vétém.

Mé perdellimin tënt te paaneshme, ó Krisht Pérendì, meshiró-na. Amen.

ZBRITESORÉ te Pashkes. UNGJILL Mengjézor V.

Dergimesoré. — T. II.

Mé pare é Pashkes, pastaj kjò :

Qendroj njëridashesi dhé Zoti i meshireshme, prane Liqénit te Dhênvé, per te sheruar semundjët; édhé gjéti nje njëri, te shtrire per shume vjët, dhé atî i thirri : Ngrér shtratin tënt dhé barit ner udhet é dréjta.

Lavderimé.

Kater Vargezimé te Tingellit III, dhé pastaj « *Pashke hiéroré* » mé Vargjët.

Lavdì. — T. T. IV. — O Zot, Ulokun nuk é sheroj Liqéni, po fiala joté é perseriti; as mundi te kundreshtohét semundja é tij é shumekoheshmé; sé véperimi i zêrit tënt u-rrefyé më i mpréhte; dhé hodhi téj barren é rênde dhé u-ngarkua mé shtratin é tij, per deshmì te shumices se meshiravé te tua. Lavdì me ty.

Tanì. — Dit' é Ngjalljés...

NE MËSHE

Hyrtoré é Pashkes, Perleshoré é Tingellit III, é Shénjtit te Kishes, dhé Shkurtoré é Pashkes.

APOSTULL

Kendojini Pérendise s' one, kendojini.

Te gjithë kombët, trokisni duarte.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

M'atô dite, ték po shkонтé Piétrri neper gjith' atô visé, zbriti dhé té Shenjtoret qe banonin Lydden. Dhé atjé gjéti nje njéri, te quajtur Enéa, i cili ishtë ulok qe dérgjéj ne shtrat qe préj tété vjéts. Edhé Piétrri i tha : « Enéa, Jésu Krishti te sheron ; ngréhu dhé shtrô shtratin tént ». Edhé ay pernjuhérësh u-ngrit. Dhé é pane gjith' atà qe banonin ne Lydde dhé ne Saron dhé u-kthyén me Zotin. Dhé ne Joppe qé nje dishépulléshe, é quajtur Tabitha, qe é kthyér dométhène Kaprolle ; kjò ish plot mé vépra te mira dhé almosha qe bënté. Dhé goditi m' atô dite te semurét é te vdése ; dhé, si é lajtin, é vune ne dhome. Dhé, mé qe Lydda ishtë prane Joppes, dishépujte, dyké degjuar qe Piétrri ish atjé, i derguan dy njéres, dhé iu-lutne te mos pertoje te shkoje gjér ték atà. Dhé u-ngrit Piétrri dhé vajti mé tà ; dhé kur arriu, é shpune ne dhome ; dhé iu-afruan gjithë te véjat, dyké qare dhé dyké i tréguar robot dhé kemishet, qe u bënté Kaprolla sa ishtë mé tô. Dhé Piétrri, si i nxori te gjithë jashte, ra me gjunje dhé u-fal ; dhé u-kthyé té kufoma dhé tha : « Tabitha, ngréhu ». Dhé ajô çéli syt' é saj dhé, kur é pâ Piétrin, u-ngrit é ndenji. Dhé i dha doren dhé é ngriti ; dhé thirri Shenjtoret dhé te véjat dhé u'a trégoj te gjalle. Dhé kjo u-bé é njohur ne tère Joppen, dhé shume bésuan me Zotin.

UNGJILL. — PAS JOANIT.

M'atê kohe, u-ngjit Jésuj ne Jérusalém. Dhé eshte ne Jérusalém prane Trégut te Dhênvé nje liqén, i quajtur Hébraisht Béthésda, qe ka pése kamaré. Ner ketô ishtë shtrire nje shumic' é madhé préj te semuresh, te

vérbersh, te çalesh, te fishkursh, qe prisnin levizjén é ujit. Sé nje Engjell zbristé me nje kohe ne liqén dhé trubullonté ujen; dhé ay qe hynté i pari pas trubullimit te ujit bêhéj i shendoshe préj çfaredô semundjéjé qe te kishté. Dhé ish atjé nje njéri, qe ish i semure per tridhiét' é téte vjét. Kur é pâ Jésuj ketê te shtrire dhé kuptoj qe po kish shume kohe keshtu, i thote : « A dô te bêhésh i shendoshe? » Dhé i semuri iu-pergjéq : « Zot, s' kam njeri qe te me hédhe ne liqén, kur te trubullohét, uja; dhé atjé ku vij une, nje tiater zbrét perpara méjé. » I thote Jésuj : « Ngréhu, ngrér shtratin têt dhé barit ». Dhé pernjuhérësh njériu u-bê i shendoshe dhé ngriti shtratin é tij dhé po baristé. Dhé ish é Shtune atê dite. Judéjte pra i thoshin te sheruarit : « Esht é Shtune; nuke te permétohét te ngrësh shtratin ». U-pergjéq atyrévé : « Ay qe me bêri te shendoshe, ay me tha : « Ngrér shtratin têt dhé barit ». E pyétne pra : « Cili esht ay njéri qe te tha : Ngrér shtratin têt dhé barit? » Po i sheruari nuke dinté cili eshte; sé Jésuj kish dale jashte, dyké qêne shumice n' atê vent. Pasandaj é gjén Jésuj ne shenteroré dhé i thote : « Shih, u-bêré i shendoshe; mos mekatô mê, qe te mos te ngjase nonje mê é kéqé ». Dhé njériu shkoj dhé u lajmeroj Judéjvé qe Jésuj esht ay qe é bêri te shendoshe.

Ne « Véçan Tereshénjten » thuhét :

Vark. — Engjelli i therristé...

Mé nje zê, ô Virgjeréshe, né bésniket te lumerojme. Gezohu, ô dér' é Zotit; gezohu, ô qytét i shpirteshme; gezohu ti, mé anen é se ciles na lindi sot drita é Ngjalljés préj se vdékuresh t'atì qe lindi préj téje.

Kungatoré é Pashkes.

E DIÉLA É SAMARITANÉS

NE MBRÊMESORÉ

Thirrtoré.

Thuhén kater Vargezimé te Tingellit IV, pastaj ketô tri te Mespésedhjétorés, dhé tri te Samaritanés :

T. IV. — Ardhi méserim' i ditevé, qe nisin nga Ngjallja shpetimtaré dhé shilohén mé Pésedhjétorén é hyjeshmé, é cila ndrit mé shkelqimét é te dyjavé, dyké i bashkuar te dyja, dhé mburrét sé paretrégon qe afrohet lafti i Shéstjes Zoteroré.

Siona degjoj dhé u-ngazellua, kur u-ungjillezua Ngjallja é Krishtit; dhé diémat é saj bésnike u-gezuan, kur é pane dhé kur u çperlau mé Shpirt njollen é Krisht-vrasjés. Po stolisét per te krémteruar méserimin gazmor te ketyré te dyjavé.

U-afua dérdhja é pasur é Shpirtit Shénjt ne te gijthe, siç eshte shkruar; vadéja leçit qe shkoj gjysma é kohes qe nga vdékja, varrimi dhé Ngjallja é Krishtit pas zotimit te vertéte qe u dha Dishépujvé per fanésjén é Ngushellimtarit.

T. I. — Qendrové prane burimit, ô burim i çudiravé, me oren é gjashtte, per te roberuar pémen é Eves; sé mé tê Eva dolli préj Parajsjes nga rréjtja é gjarperit. U-afua pra Samaritanja per te marre uje, te cilen, kur é pá Shpetimtari, tha : Ném uje te pi, dhé une do t' te mbush mé uje qe kecén; dhé é mençura réndi ne qytét, dhé i lajmeroj popullit mé nje héré : Eni, shikoni Zotin Krisht, Shpetimtarin é shpirtévé tona.

T. II. — Kur ardhi Zoti ne pus, Samaritanja é pyésté

te meshiresmin : Fal-me ujen é béses, dhé do te marr çurkat é fontit, ngazellim édhé çperblim. O Zot Jétédhènes, lavdì me ty.

T. II. — Biri i bashkepanishesme dhé i bashkaméshuar dhé Fiala é Atit qendroj prane burimit, burimi i sherimévé; dhé nje grua nga Samaria ardhi te marre uje; te cilen, kur é pâ Shpetimtari, tha : Ném uje te pi, dhé shkô é thirr burrin tënt. Dhé ajò, dyké folur si mé njéri dhé jo si mé Pérendi, dhé dyké dashur te fshihéj, thoshtë : S' kam burre. Dhé Mesonjesi i tha : Mire thé S'kam burre, sé ké patur pése dhé ay qe ké tanì s'eshte burri yt. Dhé ajò, é çuditur mi ketê fiale, réndi ne qytét dhé i therristé popullit, dyké thène : Eni, shikoni Krishtin, qe i dhuron botes perdellimin é math.

Lavdì. — *T. T. II.* — Prane pusit te Jakobit Jésuj gjéti Samaritanén, dhé lyp uje préj saj ay qe mbulon dhéne mé ré. O çudi ! ay qe rri mi Qérubimét kuvendonté mé nje grua mérétrike; kerkonté uje ay qe dérth burimé dhé liqéné ujerash, sé déshtë t'a shpetoje mé te vertéte atê qe ndiqéj préj armikut luftetar, dhé te vadite mé uje jété atê qe digjéj tmérrerisht ner paudhesira, si i vétém i meshireshme dhé njéridashes.

Tanì. — *T. IV.* — Proféti David...

Pasvarjé.

Thuhét Pasvargu i pare i Tingellit IV, dhé pastaj « *Pashke hiéroré* » mé Vargjét.

Lavdì. — *T. T. IV.* — Kur u-duké mi dhé pas urdherimit te patréguar, ô Krisht Pérendi, dhé degjoj Samaritanja fialen tëndé njéridashesé, lâ shtëmben ne pus dhé réndi dhé u tha atyrévé qe ishin ne qytét : Eni, shikoni zemernjohesin. Mos eshte ky Krishti qe pritét, qe ka perdellimin é math?

Tanì. — Dit' é Ngjalljés...

Perleshoré.

Mê pare thuhét é Tingellit IV, pastaj é se Krémtés :

T. T. IV. — Sot qe méseron é krémtja, shpirtin t' im qe ka étjé vadit-é mé çurka piététi; sé u thirrë te gjithëvé, ô Shpetimtar : Kush ka étjé lé te vije té mua dhé lé te pije. O Krisht Pérendi, burim i jétes, lavdi me ty.

NE MENGJËS

Ndenjesoré, Degjim dhé Shkallësa te Tingellit IV.

Shkurtoré. — T. T. IV.

Samaritanja ardhni ne pus mé bése, dhé te pâ ty, ujen é urtesise, mé te cilen si u-vadit pasurisht, trashegoj mbréterin' é larte é perkujtuara.

Shpia.

Lé te degjojme myshtérét é ndëruara qe na i trëgon Joani si ngjajtin ne Samari; si Zoti flisté mé nje grua, dhé i lypi uje ay qe mblodhi ujerat ne permbledhjët é tyré, i bashkefroneshmi mé Atin é mé Shpirtin; sé ardhni te kerkoje koren é tij per jéte i perkujtuari.

Synaksar.

Gjithe sot, te Diëlen é Péste pas Pashkes, krémterojme te krémtën é Samaritanés, é cila pastaj deshmoj mé émerin Fotini.

Ardhé te marresh uje te dhëshmé, ô grua,

Dhé moré ujen, mé te cilen çperlavé njollat é shpirtit.

Mé nermjëtimit é Deshmores s' até Fotini, ô Krisht Pérendi, meshirô-na. Amen.

ZBRITESORÉ te Pashkes. UNGJILL Mengjëzor VII.

Dergimesoré. — T. II.

Mê pare é Pashkes, pastaj kjô é Samaritanés dhé é Mëspësedhiëtorés:

Vajtë ne Samari, ô Shpetimtari im i tërefuqishim, dhé folé mé nje grua, dhé i kerkové uje per te pire, ti

qe u burové uje Hébréjvé préj nje shkêmbi te perpiéte, te cilen é pruré té bésa joté dhé tanì gezon jéten ner qiéj per jéte.

Kur méseronté é krémtja, ardhé, ô njéridashes, né shenteroré dhé flisnjé : Ju qe kini étjé, éjani té mua dhé mérrni uje te gjalle qe kecén, mé te cilen do te gezoni te gjithë defrim dhé hir dhé jéte te pavdékur.

Lavderimé.

Kater Vargezimé te Tingellit IV, dhé pastaj « *Pashke hiéroré* » mé Vargjét.

Lavdi. — *T. T. II.* — Kryéburimi i jétes, Jésuj Shpetimtari yne, qendroj prane burimit te Patrikut Jakob, dhé lypté uje per te pire nga nje grua Samaritané. Dhé, kur i foli ajô per mosqasjén é Judéjvé, Krijétari i urte mé fiale te urta é shpié te kerkoje më téper ujen é améshuar; te cilen si é mori, u leçiti te gjithëvé, dyké thêne : Eni, shikoni Pérendine dhé njohesin é te fshéhtavé, qe ardhi truperisht per te shpetuar njérine.

Tanì. — Dit' é Ngjalljés...

NE MÉSHE

Hyrtoré é Pashkes, Perleshoré é Tingellit IV, Pastaj « *Sot qe méseron é krémtja* », é Shénjtit te Kishes, dhé Shkurtoré é Pashkes.

APOSTULL

Sa te mehda jane véprat é tua, ô Zot; te gjitha i béré mé urtesì.

Békô Zotin, ô shpirti im.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

M' atô dite, Apostujte, qe u-perndane nga ndjékja qe u-bé per Stéfanin, udhetuan gjér ne Fénike dhé ne Kypre dhé n'Antioki, dyké mos i leçitur fialen asnonjejt véç sé Judéjvé vétém. Dhé ca nga atà ishin njéres Kypriane dhé Qirinéas, te cilet, kur hyjtin ne Antioki,

u flisnin Hélénistevé, dyké ungjillezuar Zotin Jésu. Dhé dora é Zotit ish mé ta; dhé nje numur i math bésuan dhé u-kthyén me Zotin. Dhé ardhi lajme per ketô gjêra ne vëshet é Kishes qe ish ne Jérusalém; dhé derguan Barnaben qe te shkoje gjér ne Antiokì. I cili, kur vajti dhé pâ hirin é Zotit, u-gezua dhé i éksortonté te gjithe te mbétén me Zotin mé qellim zemré, sé ish nje njérì i mire dhé plot mé Shpirt Shénjt dhé mé bése; dhé u-shtua miaft popull mé Zotin. Dhé Barnaba shkoj ne Tarse qe te kerkoje Saulin; dhé, si é gjéti, é pruri ne Antiokì. Dhé nje mot te tère mblidheshin ne Kishe dhé mesonin miaft popull, dhé dishépujte u-quajtin te Krishtëre per te paren hére ne Antiokì. Dhé ne ketô dite, zbritne proféter préj Jérusalémit ne Antiokì. Dhé u-ngrit nje préj syrësh, i quajtur Agab, dhé shenoj mé anen é Shpirtit Shénjt qe do te ngjase nje famine é madhé me tère boten, é cila ngjau me ditet é Qésar Klaudit. Ahéré dishépujte, si pas fuqise sicilidô, i dhane funt t' u dergojne ndihma vellézervé qe banonin ne Judé; te cilen é bêne, dhé u'a derguan pléqvé mé doren é Barnabes dhé te Saulit.

UNGJILL. — PAS JOANIT.

M'atê kohe, vjén Jésuj ne nje qytét te Samarise, te quajtur Sihar, afer ares qe i kish dhêne Jakobi te birit te tij Joséf; dhé atjé qé pus' i Jakobit. Jésuj pra, i lodhur préj udhetimit, ndenji prane pusit; dhé ora ish sidonja gjashte. Vjén nje grua préj Samarise per te marre uje. I thote Jésuj. « Ném te pi ». (Sé dishépujt é tij kishin shkuar ne qytét per te blére te ngrêna). I thote pra gruaja Samaritané : « Si ti, qe jé Judé, lyp uje préj méjé, qe jam nje grua Samaritané? Sé Judéjte s' kane marredhênié mé Samaritanet ». U-pergqjéq Jésuj dhé i tha : « Po te dijé dhuretin' é Pérendise dhé cili esht ay qe te thote, *Ném te pi*, ti do t' i lypjé dhé do t' te

kishté dhêne ujen é gjalle ». I thote gruaja : « Zot, as kove s' ké, édhé pusi eshte i thélle. Ngaha pra é ké ujen é gjalle? Mos jé ti mê i math sé âti yne Jakob, i cili na é dha pusin dhé qe piu véte préj tij dhé te bijte, dhé bageti' é tij? » U-pergjéq Jésuj dhé i tha : « Cilidô qe pi préj keti uji do te kéte prape étjé; po ay qe te pije préj ujit qe do t' i jap une do mos kéte étjé per jéte; po uja qe do t' i jap do te bêhét ték ay burim uji qe kecén me jéte t'amëshuar ». I thote gruaja : « Zot, ném ketê uje, qe te mos kém étjé as te vij ketu te marr uje ». I thote Jésuj : « Shkô, thirr burrin têt dhé éja ketu ». U-pergjéq gruaja dhé tha : « S' kam burre ». I thote Jésuj : « Mire thé qe s' kam burre; sé paté pése burra, dhé ay qe ké tani nuk eshte burri yt; ketu folé te vertéten ». I thote gruaja : « Zot, shoh qe ti jé profét. Aterit tane kane adhuruar ne ketê mal; po ju thoni qe ne Jérusalém eshte vendi ku duhét adhuruar ». I thote Jésuj : « Grua, bêsô-me qe vjén ora, kur as ne ketê mal, as ne Jérusalém do t'a adhuroni Atin. Ju adhuroni atê qe nuke dini; né adhurojme atê qe dime; sé shpetimi vjén préj Judéjvé. Po vjén ora, dhé tanì eshte, kur adhuronjesit é vertéte do t'a adhurojne Atin mé Shpirt dhé mé te vertéte; sé te ketije i dô Ati atà qe é adhurojne. Pérendia eshte Shpirt dhé adhuronjesit é tij duhét t' a adhurojne mé Shpirt dhé mé te vertéte ». I thote gruaja : « Di qe vjén Mésia, qe thuhét Krisht; kur te vije ay, do te na i thote te gjitha ». I thote Jésuj : « Une qe te flas jam ». Dhé mi ketê ardhe Dishépujt é tij dhé u-çuditne qe po flisté mé nje grua, po asnje nuke tha : « Ç' kerkon, a persé flét mé têt? » Gruaja pra là shtêmben é saj dhé shkoj ne qytét dhé u thote njéresvé : « Eni te shikoni nje njérì, i cili me tha te gjitha sa kam bêre; valle mos eshte ky Krishti? » Dualle pra préj qytétit dhé vinin ték ay. Dhé n' atê mës, i luteshin Dishépujt é tij, dyké thêne : « Rabbi, haj ». Po ay u tha :

« Une kam te hà nje te ngrêne, te cilen ju nuk é dini ». Thoshin pra Dishépujte mé njêrjatrín : « Mos i solli njêrì per te ngrêne? » U thote Jêsuj : « E ngrêna imé eshte te bêj dashurin' é atì qe me dergoj dhé te mbaroj punen é tij. Nuke thoni ju qe duhén êdhé kater muaj, dhé pastaj vjén te korret? Já, po ju thom, ngréni syte tuaj dhé shikoni arat, sé jane te bardha per te korrur. Dhé ay qe kor mérr rroge dhé mbléth péme per jéte t'améshuar; qe te gezohét bashke dhé ay qe mbiéll dhé ay qe kor. Sé mi ketê fiala esht é vertéte qe tjater esht ay qe mbiéll dhé tiater ay qe kor. Une ju dergova te korni atê per te cilen nuke jini numduar; te tiére jane munduar, dhé ju kini hyre ne mundim te tyré. » Dhé préj atì qytéti shume préj Samaritanévê i bésuan per fialen é gruas qe deshmonté qe, Me tha te gjitha sa kam bêre. Kur ardhe pra ték ay Samaritanet, i luteshin te mbétét mé tà; dhé mbéti atjé dy dite. Dhé shume mê téper bésuan per fialen é tij, dhé i thoshin gruas : Qe nuke bésojme mê per fialen têndé; sé tanì degjuam véte dhé dime qe ky eshte mé te vertéte Krishti, Shpe timtar i botes.

Ne « *Véçan Têreshénjten* » thuhét :

Vark. — Engjelli i therristé...

Defré, ngazellohu, dér' é hyjeshmé é drites, sé Jêsuj qe pérendoj ne varr lindi perserì, dhé shkelqéu mê gazmorisht sé diélli, dhé ndriçoj te gjithë bésniket, ô Zonje é hyjhireshmé.

E DIÉLA É TE VÉRBERIT

NE MBRÊMESORÉ

Thirrtoré.

Thuhén shtate Vargezimé te Tingellit Terthor I, dhé dy te Vétezêshmé te Vérberit, dyké persedytur te paren :

T. II. — I linduri i vérber thoshtë mé mendjén é tij : Valle mos linda i vérber nga mekatét é prindervé? Valle mos linda si prove per pabésin' é paganevé? Nuke jam i zoti te thom kûr eshte nate dhé kûr eshte dite. Kêmbet é mia nuke jane miaft te forta per goditjét é gurevé; sé nuke pashe diéllin te shkelqéje, as é pashe ne kore até qe me gatoj ; po te lutém, ô Krisht Pérendì : Hith syrin mi mua, édhé meshirô-me.

Dyké shkuar Jésuj préj shenterorés, gjéti nje njéri te vérber qe préj lindjés; dhé i ardhi kéq, dhé vuri balte mi syt' é tij, dhé i tha : Shkô, lahu ne liqén te Siloamit; dhé, si te lahésh, çél-i syte, dyké lavderuar Pérendine. Dhé gjirijt' é tij i thoshin : Kush t' i çéli syte, te cilet s' mundi asnje njéri mé sy te t' i sheroje? Dhé ay thirri é tha : Nje njéri, i quajtur Jésu, ay me tha : Lahu ne liqén te Siloamit, dhé i çéla syte. Ky eshte mé te vertéte Krishti Mésia, per te cilin tha Moisiu ne ligje. Ky eshte Sheptimtari i shpirtévé tona.

Lavdì. — *T. T. I.* — O Zot, dyké shkuar mb' udhe, gjété nje njéri te vérber qe préj lindjés; dhé Dishépujte te çuditur te pyésnin, dyké thêne : Mesonjes, cili mekatoj, ky, apo prinderit é tij qe lindi i vérber? Dhé ti, ô Shpetimtari im, u therrisnjé : As ky mekatoj, as prinderit

é tij, po qe te çfaqén mi tê véprat é Pérendise. Une duhét te mbaroj véprat é atî qe me dergoj, te cilat asnonje s' munt t' i mbaroje. Dhé, si thé ketô, peshtyré perdhè, bêré balte, dhé i lévè syte, dyké thêne : Shkô lahu ne liqén te Siloamit. Dhé ay, si u-lâ, u-bê i shendoshe dhé te therristé : Bésoj, ô Zot, dhé t'u-fal. Perandaj therrésim dhé né : Meshirô-na.

Tanî. — Ne Dèt te Kuq...

Pasvargjé.

Thuhét Pasvargu i pare i T. T. I., dhé pastaj « *Pashke hiëroré* » mé vargjét.

Lavdî. — *T. T. IV.* — O Krisht Pérendî, Diéll mendor dréjtesié, ti qe ndrité shpirtin dhé trupin é atî qe lindi i vérber mé prékjén é dores s' até se panjolleshmé, ndrit édhé syt' é shpirtévè tona, trégô-na bij drité, qe te te therrésim mé bése : Meshira joté per né eshte é shumet dhé é patréguar. Njéridashes, lavdî me ty.

Tanî. — Dit' é Ngjalljés.

Perleshoré dhé Hyjlindesoré é T. T. I.

NE MENGJËS

Ndenjesoré, Degjim dhé Shkallésa te T. T. I.

Shkurtoré. — *T. IV.*

I ulokesuar nga syt' é shpirtit, ty, ô Krisht, prane te vij, si i Vérberi qe préj lindjés, dhé ne pëndim po te therrés : Ti jé drita é shkelqyer é atyrévè qe ndodhén n' érrësire.

Shpia.

Dhurô-me, ô Krisht, lume urtesié te patréguar dhé dije te larte, ô drit' é atyrévè qe ndodhén n' érrësire, dhé udhehéqes i te arratisurvè, qe te trégoj atô qe na mesoj libra é hyjeshmé é Ungjillit te paqes, dométhène

çudin' é te vérberit; sé, dyké qêne i vérber qe préj lindjés, gezon syt' é trupit dhé te shpirtit, dhé therrét mé bése : Ti jé drita é shkelqyér é atyrévé qe ndodhén n' érsesire.

Synaksar.

Gjithe sot, te Diélen é Gjashte pas Pashkes, krémterojme çudin' é te Vérberit préj Zotit dhé Pérendise dhé Shpetimtarit tone Jésu Krisht.

Fales i drites, drit' é lindur préj drité,

I çêlé syte te Vérberit qe préj Lindjés, ô Fiale.

Pas perdellimit têt te paaneshme, ô dritedhènes Krisht, Pérendia jone, meshirô-na, édhe shpetô-na. Amen.

Zbritesoré. — T. T. I.

I. Pérendise Shpetimtaré, qe i hoqi udhen popullit ne dét mé këmbe te palagura dhé permbyti Faraonin mé gjith' ushterì, atí vétém lé t' i kendojme, sé u-lavderua.

III. Mé fuqin' é Kryqit têt, ô Krisht, shigurôm'a mendjén per te hymnuar dhé per te lavderuar Shéstjén tëndé shpetimtaré.

IV. Degjova famen é potères se Kryqit, si u-çél Parajsa mé anen é tij, dhé thirra : Lavdi fuqise s' até, ô Zot.

V. Dyké menguar te therrésim, ô Zot : Shpetô-na. Sé ti jé Pérendia jone, véç téjé nuke njohim tiater.

VI. Me qarkoj avusha, baléna m' u-bê varr, dhé une thirra té ty njéridashesi, dhé me shpetoj é diathta joté, ô Zot.

VII. E békuar eshte Pérendi' é Atervé tane qe shpetoj ne furre te ziarrit Diémat kêngetare.

VIII. Birin dhé Pérendine, qe lindi préj Atit para jétévé dhé ner koherat é fundit u-misherua préj Nênes Virgjeréshe, prifter é hymnoni, popull é permilartsoni per gjithe jétet.

IX. Ty, Nênen é Pérendise permi mendjé dhé aresyé,

qe lindé pa trégim me kohe te pakoheshmin, né bésniket mé nje mendjë po te madheshtojme.

UNGJILL Mengjézor VIII.

Dergimesoré. — T. II.

Mê pare é Pashkes, pastaj ketô te dyja :

Syt' é mi mendore, ô Zot, te vérbuar préj mekatit te erret, ti ndrit-i, ô i Meshireshme, dyké u véne perunjesi dhé dyké i qeruar mé lotét é pendimit.

Shpetimtari yne, dyké shkuar, gjéti nje te Vérber; peshtyri perdhé, bêri balte dhé i lyéjti syte, dhé é dergoj ne Siloam qe te lahéj; dhé ay, si u-lâ, ardhi mé syte hapur, ô Krisht.

Lavderimé.

Kater Vargezimé te T. T. I, pastaj « *Pashke hiéroré* » mé Vargjét.

Lavdi. — T. T. I. — Cili do te flase per fuqit' é tua, ô Krisht? A cili do te numeroje shumicat é çudiravé te tua? Sé, nga qe u-duké mi dhè dyplik nga miresia, dypliké u falnjé sherimét te semurevé; sé jo vétem syt' é trupit i çélé te vérberit qe préj lindjés, po dhé syt' é shpirtit. Perandaj te rrefénté si Pérendi ty qe fshiheshé dhé qe u fal te gjithévé perdellimin é math.

NE MÉSHE

Hyrtoré é Pashkes, Perleshoré é T. T. I, é Shénjtit te Kishes, dhé Shkurtoré é Pashkes.

APOSTULL

Ti, ô Zot, te na ruash é te na permbash.

Shpetô-me, ô Zot, sé humbi oshenari.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

M' atô dite, ték shkonim né Apostujte ne faljë, na hasi nje vajze qe kish fryme Pythoni, qe u jipté shume andralla te-zotervé te saj, dyké divinuar. Kjô i ra pas

Paulit dhé névé dhé therristé dyké thêne : « Ketà njêres jane sherbetore te Pérendise se larte, qe na lajmerojne udhen é shpetimit ». Dhé ketê é bênté per shume dite. Dhé u-merzit Pauli dhé i' u-kthyé frymes é i tha : « Te urdheroj, me émerin é Jêsu Krishtit, te dalesh préj saj ». Dhé dolli m' atê çast. Dhé kur pane te zoterit qe dolli shprésa é punes se tyré, é zune Paulin dhé Silen dhé i hoqne ne trék perpara krérevé; dhé i prune perpara gjénéralevé, dhé thane : « Ketà njêres na trubullojne qytétin, dyké qêne Judéj, dhé leçitin zakoné qe s' na permétohet névé t' i akséptojme, as t' i bêjme, dyké qêne Romane ». Dhé u-sul turma kunder syrêsh, dhé gjéneralet, dyké çierre robot é tyré, urdheruan qe t' i rrahin. Dhé passi i rahne shume, i hodhe ne burk, dyké porositur burgetarin t' i ruaje mire; i cili, si mori te ketille porosì, i hodhi ne burgun mê te thêlle dhé i shiguroj kêmbet é tyré ne dru. Po nga mézi i nates, Pauli dhé Sila, dyké u-falur, hymnojin Pérendine; dhé te burgosurit i degjojin. Dhé bэфas u-bê nje termét i math, sa u-tronditne thémelit' é burgut; dhé u-hapne mé nje hére te gjitha dyérte dhé u-zgjidhe vargojt' é te gjithévé. Dhé kur u-zgjua burgetari dhé pà dyért' é burgut te hapura, nxori shpaten dhé gatitéj te vristé vétén, dyké kujtuar qe i kishin ikur te burgosurit. Dhé thirri mé zê te math Pauli, dyké thêne : « Mos i bêj vétés gjê te kéqé; sé te gjithë jémi ketu ». Dhé ay lypi dritera dhé u-sul brenda dhé i tmérruar i rà ner kembe Paulit dhé Siles. Dhé si i shpuri jashte, u tha : « Zoterij, ç' duhét te bêj qe te shpetohém ? » Dhé atà, i thane : « Besô me Zotin Jêsu Krisht dhé do te shpetosh ti dhé shtepia joté ». Dhé i fole fialen é Zotit atì dhé gjith' atyrévé qe ishin ne shtepì te tij. Dhé i mori m' atê ore te nates, dhé u lau plaget; dhé u-pagezua ay dhé gjithë shtepi' é tij mé nje hére. Dhé i shpuri ne shtepì te tij dhé u shtroj tryése dhé

u-ngazellua, dyké i bésuar Pérendise mé gjithe shtepin' é tij.

UNGJILL. — PAS JOANIT.

M'atê kohe, dyké shkuar Jésuj, pâ nje njèrì te vérber qe préj lindjës. Dhé é pyétne Dishépujt é tij, dyké thêne : « Rabbi, cili mekatoj, ky a po prinderit é tij, qe lindi i vérber? » U-perqjéq Jésuj : « As ky mekatoj, as prinderit é tij, po qe te çfaqén mi tê véprat é Pérendise. Une duhét te mbaroj véprat é atì qe me dergoj sa eshte dite; sé vjén nata, kur asnonje s' munt te punoje. Sa jam ne bote, jam drit' é botes ». Si tha ketô, peshtyri per-dhè, bëri balte préj peshtymes dhé lyéjti mé balten syt' é te vérberit, dhé i tha : « Shkô, lahu ne liqén te Siloamit » (é cila perkthéhét, i Derguari). Shkoj pra dhé u lâ dhé ardhi mé syte çélur. Fqinjte pra dhé atà qe é shikonin më pare qe ish i vérber thoshin : « Nuk eshte ky ay qe rrinté dhé lypté? » Te tiére thoshin, Qe ky eshte. Te tiére prape, Qe i shembellén atì. Po ay thoshtë, Qe une jam. I thoshin pra : « Si te jane çélur syte? » Dhé ay u-pergjéq é tha : « Nje njèrì, i quajtur Jésuj, bëri balte dhé m' i lyéjti syte dhé me tha : Shkô ne liqén te Siloamit dhé lahu. Dhé si shkova dhé u-lava, pashe ». I thane pra : « Ku esht ay? » Ay thote : « Nuke di ». E shpién té Farisianet atê qe ish më pare i vérber. Dhé ish é Shtune, kur Jésuj bëri balte dhé i çéli syte. E pyésnin pra perserì dhé Farisianet qysh pâ. Dhé ay u tha : « Me vuri balte mi syte dhé u-lava dhé shoh ». I thoshin pra ca préj Farisianeve : « Ky njèrì nuk esht i Pérendise, sé nuke mban te Shtunen ». Te tiére thoshin : « Si munt nje njèrì mekatar te bëje çudira te ketija? » Dhé u-bê nje çarjé ner tà. I thone perserì te vérberit : « Ti ç' thua per atê qe te çéli syte? » Dhé ay tha, Qe eshte profét. Po Judéjte nuke bésonin qe ay qé i vérber édhé pâ, gjér sa thirre prinderit é atì qe çéli syte. Dhé

i pyétne, dyké thêne : « A eshte biri juaj ky, qe ju thoni sé lindi i vérber? Si pra tani shéh? » Dhé u-pergjéqne prinderit é tij dhé thane : « Dime qe ky eshte biri yne dhé qe lindi i vérber; po nuke dime si tani shéh, as nuke dime cili ia çéli syte; ay ka moshe; pyésni atê; lé te flase véte per véten é tij ». Ketô thane prinderit é tij, sé ndrueshin préj Judéjvé; sé Judéjte po ishin marre vésh qe kush t' a rreféje per Krisht te nxirét jashte synagojes. Perandaj prinderit é tij thane, qe ay ka moshe, pyésni atê. E thirre pra per se dyti njérine, qe ish i vérber, dhé i thane : « Lavderô Pérendine; né dime qe ky njëri eshte mekatar ». U-pergjéq pra ay dhé tha : « Nuke di ne eshte mekatar; një di qe isha vérber dhé tani shoh ». I thane pra perseri : « Ç' te bëri? Si t' i çéli syte? » U-pergjéq ték atà : « Po ju thashe dhé nuke me degjuat; persé doni perseri te degjoni? Mos doni dhé ju te bëhëni dishépuj te tij? » E shane pra dhé i thame : « Ti jé dishépull i tij; né jëmi dishépuj te Moisiut. Né dime qe Moisiut i foli Pérendia. Po ketê nuke é dime ngaha eshte ». U-pergjéq njëriu dhé u tha : « Kjô eshte per çudi qe ju nuke dini ngaha eshte, po ay m' i çéli syte; dhé dime qe Pérendia nuk i degjon mekatarët; po, ne qofte nonje qe ndéron Pérendine dhé bën deshiren é tij, atê é degjon. Kurre nuk eshte degjuar qe dokush i çéli syte nje te linduri te vérber. Po te mos qé njëri i Pérendise ky, nuke do te muntté te bënté asgjé ». U-pergjéqne dhé i thane : « Ti ké lindur ne mekaté i tère, dhé ti na meson? » Dhé é nxuare jashte. Degjoj pra Jësuj qe é nxuare jashte dhé, si é gjéti, i tha : « Ti à beson me Birin é Pérendise? » U-pergjéq ay dhé tha : « Cili esht, ô Zot, qe t' i bésoj? » Dhé i tha Jësuj : « Dhé é ké pare, dhé ay qe flét me ty, ay eshte. » Dhé ay tha : « Bésoj, ô Zot »; dhé iu-fal.

Ne « *Vëçan Tëreshenjten* » thuhét : « Engjelli i therristé... Ndriçohu, ndriçohu »; Kungatoré é Pashkes.

SHESTJA

NE MBRËMESORË

Thirrtoré. —T. T. II.

Thuhén per se dyti qe te pésa :

Zoti u-shéstjua ner qiéjte qe t' i dergoje botes Ngushellimtarin. Qiéjte gatitne fronin é tij; Engjejte çuditén, dyké shikuar nje njèri permi tà. Ati prêt até qe ka ne gji te bashkaméshuar. Shpirti Shénjt u urdheron gjithë Engjejvé te tij : Lé te çélin dyérte, kryétaret tuaj. Te gjithë kombét, trokisni duarte; sé u-ngjit Krishti atjë ku ish më pare.

Zot, Qérubimét u-çuditne mé Shéstjén tëndé, dyké pare te ngjitësh mi réte ti qe rri mi tà; dhé te lavderojme, sé meshira joté esht é mire. Lavdì me ty.

Dyké pare lartésimét é tua ner malét é shenteruar, ô Krisht, agullim i lavdise s' Atit, perhymnojme fytyren é ndriçimé te faqés s' até, adhurojme Pesimét é tua, ndérojme Ngjalljén, dhé lavderojme Shéstjen é lavderuar. Meshirô-na.

Zot, kur te pane te ngrihësh mi réte, Apostujte, plot mé hidherim, dyké qare mé lot é dyké vajtuar, thoshin : Zot, mos na lër varfanjake né sherbetoret é tu qe na dëshé nga meshira, si i zemerdhempshur; po dergô-na Shpirtin tént Têreshénjt, sikunder na u-zotové, qe te na ndriçoje shpirtét.

Zot, si mbarové myshtérin é urdherimit, moré Dishépujt é tu dhé i ngjité ne mal te Ullinvé; dhé já ku shkové permi kulmin é qiéllit. Ti, qe u-béré per

mua i varfer si une, dhé u-ngjité atjë ngaha nuk undavé, dergô Sphirtin tënt Têreshénjt, qe te na ndriçoje shpirtét.

Lavdi é Tanì. — Pa u-ndare préj gjirit ateror, ô Jésu fort i êmbel, dhé passi u-shokerové mé njézerit, sot u-shéstjové mé laft préj malit te Ullinjvé; dhé passi lartesové miresisht natyren tone te rêne, ndenjé bashke mé Atin. Perandaj pra urdherét qiëlloré te Engjejvé mahniteshin per ketê çudi; dhé, te permbledhur mé tmërr, madheshtonin njéridashjén tëndé. Mé te cilet dhé né te dhëshmit, dyké lavderuar zbritjén té névé dhé Shéstjén préj nësh, lutémi dyké thêne : Ti, qe mbushé mé gas Dishépujte dhé Hyjlindesén qe te lindi mé Shéstjén tëndé, vléresô-na dhé né per gazin é te zgjédhurvé te tû, mé urimét é tyré, pas perdelimit tënt te math.

Hyrjë, « *Drite gazmoré* » dhé ky PAREVARK :

T. i Rênde. — Vir ré te falurit t' im, ô Pérendì, dhé mos çperhith lutjén t' imé.

Pasvargjë. — *T. II.*

Lindé, siç déshé véte; u-duké, siç te pelqéu; pesové truperisht, ô Pérendia jone; u-ngjallé préj se vdékuresh dyké shkélur vdékjén; u-shéstjové mé lavdi, ti qe mbush gjithesine; dhé na dergové Shpirtin é hyjeshme, qe te perhymnojme dhé te lavderojme Hynine tëndé.

Vark. — *Te gjithë kombét, trokisni duarte.*

Kur shéstjoheshé, ô Krisht, préj malit te Ullinjvé, te pane Fuqirat dhé i therrisnin njêrjatres : Cili eshte ky? Dhé u thote : Ky eshte i forti dhé i potëshmi; ky esht i fuqishmi ner lufterat; ky eshte mé te vertéte Mbréti i lavdise. Dhé persé jane te kuqé robot é tij? Sé vjén préj Bosorit, dométhêne, préj trupit. Dhé ti, passi ndenjé si Pérendì me te diathte te madheshtise, na

dergové Shpirtin Shénjt qe te udhëhéqe dhé te shpetoje shpirtét tona.

Vark. — *U-ngjit Pérendia mé brohorì.*

U-shéstjové mé lavdì préj malit te Ullinjvé perpara Dishépujvé te tû, ô Krisht Pérendì, dhé ndenjë me te diathte te Atit, ti qe i mbush te gjitha mé Hynine; dhé u dergové Shpirtin Shénjt, qe ndriçon dhé pshtét dhé shenteron shpirtét tona.

Lavdì é Tanì. — *T. T. II.* — U-ngjit Pérendia mé brohorì, Zoti mé zê trumbété, qe te lartesoje koren è rêne te Adamit dhé te dergoje Shpirtin Ngushellimtar per te shenteruar shpirtét tona.

Perleshoré. — *T. IV.*

U-shéstjové mé lavdì, ô Krisht Pérendia jone, dhé gezové mé zotimin é Shpirtit Shénjt Dishépujte, te cilet u-shiguruan mé békimin qe ti jé i Bir' i Pérendise, Çperblénjesi i botes (*tri hère*).

NE MENGJËS

Ndenjesoré.

T. I. — *Pas « Tu lithu ».* — Kur Engjejte admironin çudin' é Shéstjés, dhé Dishépujte mahniteshin per lartesimin é tmërruar, u-ngjité mé lavdì si Pérendì, édhe dyérte t' u-çele, Shpetimtar; perandaj Fuqit' é qiéjvé çuditeshin dhé therrisnin : Lavdì zbritjés s' até, Sheptimtar; lavdì mbréterise s' até; lavdì Shéstjés s' até, i vétëm njëridashes.

T. III. — *Pas « Tin oréotita ».* — Pérendia é parejéteshmé dhé é panësheshmé u-shéstjua sot, passi hyjesoj myshtikerisht natyren njërezoré qe mori. Pareréndin Engjejte dhé u trégonin Apostujévé atë qe po shkонтé ner qiéjte mé laft te math; dhé atì si iu-fale, thane : Lavdì Pérendise qe u-shéstjua.

T. T. I. — Pas « Ton sinanarhon ». — Zbrité mi te dhëshmét préj qiëllorévé, dhé si ngjallé Adamin, i cili që perposh, ne burk te Férrit, ô Pérendi, mé shéstjén tëndé, ô Krisht, é ngjité lart ne qiëll, dhé é vuré te rrije mé ty permi fronin ateror, si njëridashes dhé i meshireshme.

« Qe préj dialerise s' imé ».

Parevark.

U-ngjit Pérendia mé brohori, Zoti mé zê trumbété.
Vark. — Te gjithë kombét, trokisni duarte.

UNGJILLI Mengjézor III, « Mé-qëne-qe pame Ngjalljén » dhé Psalmi 51.

Lavdi. — Mé nermjétimét é Apostujvé...

Tani. — Mé nermjétimét é Hyjlindesés...

Perdellyes, perdellé-me, ô Pérendi...

T. T. II. — Sot Fuqit' é larta, dyké pare natyren tone ner qiéjte, mahniteshin per menyren é çudiçimé te ngjitjés, dhé thoshin mé njëjrjatin: Cili eshte ky qe ardhi? Dhé, kur pane Zotin é tyré, urdheroheshin te çélin dyérte qiëlloré. Mé te cilet te hymnojme pa pushim ty, qe do te vish perseri s' andéjmi truperisht, si gjykates i te gjithavé dhé si i têrefuqishim.

Shkurtoré. — T. T. IV.

Passi mbarové urdherimin per né dhé bashkové te dhëshmét mé qiëllorét, u-shestjové mé lavdi, ô Krisht Pérendia jone, pa u-ndare préj gjekundi, po dyké mbétur afer, dhé dyké u thirrur atyrévé qe te dëshnin: Une jam mé ju, dhé asnjé s' eshte kundër jush.

Shpia.

Dyké lêne te dhëshmét mi dhé, é dyké i dhëne shurit te hiëshmét, éni te sqohémi dhé te ngréme lart syte dhé méjtimét; lé t' i hédhim pamjét édhé ndjénjat bashke

mi dyërte qiëlloré né njérezit; lé te kujtojme qe jémi ne mal te Ullinjvé dhé te shohim Çperblénjesin te hipur mi ré; sé s' andéjmi Zoti réndi ner qiéjte; s' andéjmi gjenérozi u perndau dhuratat Apostujvé te tij, dyké i ngushelluar dhé dyké i kurajuar si Ate, dyké i udhëhëqur si bij, dhé dyké u thëne : Nuke ndahém préj jush; une jam mé ju, dhé asnje s' eshte kunder jush.

Synaksar.

Gijthe sot, te Enjtën é Javes se Gjashlle pas Paskhes, krémterojme Shéstjën é Zotit dhé Pérendisë dhé Shpetimtarit tone Jësu Krisht.

Dyké ndenjur me te diathten ateroré, ô Fiale,

U falé Dishépujvé bése më te shigurte.

O Krisht Pérendia jone, qe u-shéstjové më lavdì, meshiró-na. Amen.

Zbritesoré. — T. IV.

I. I mbuluar préj miégullé te hyjeshmé, belbecaku oratoroj ligjen é hyjshkruar; sé, dyké shkundur balten é syrit te mendjës, shikon te qênin dhé nisjohét me dijen é Shpirtit, dyké lavderuar mé kënge te pérendishmé.

III. I dermoj vargojt' é barkut shtërp dhé sharjén é pambajtur te mirpiëllorés lutja vétém é profétëshes se motshimé Anna, qe u-perunj mé shpirt te dermuar té Fuqimadhi dhé Pérendi' é dijavé.

IV. O Mbrét i mbrétervé, ô Fiale, qe lindé vétém préj Atit pa-nisjë i tille préj te tillit, u dergové si mirebêres Shpirtin tënt te njefuqishim dhé te pavdëkur Apostujvé qe kendojne : Lavdì fuqise s' até, ô Zot.

V. Pritni vésen é Shpirtit te frymeziarrte, si spastrim zgjidhes te paudhesivé, ô diéma te dritefytyreshme te Kishes; sé tanì ka dale préj Siones ligja, hiri i Shpirtit, ne forme gjuherash ziarri.

VI. Si meshirim dhé shpetim na shkelqévé préj Virgjerëshes, ô Zoti Krisht, qe te rrembësh nga prishja

tère Adamin, qe ra mé gjithë gjindjén é tij, sikunder shpetové Profétin Jona préj kraherorit t' égersires se détit.

VII. Mé nje zê buçiti kênge shtruméntësh per te ndéruar vépren pa-shpirt te gatuar mé ar; po hiri driteprures i Ngushellimtarit i therrét mé vénérím. O Trinì é vétém, é njefuqishmé dhé é paniseshmé, é békuar jé.

VIII. I zgjith vargojte dhé é véson flagen shtypi i trishkelqimshim i théarqise; é hymnojne Diémat, dhé tère ndertésa é krijuar békon te vétemin Shpetimtar dhé véperimtar te gjithesise si mirebêres.

Prifti thote : « *Hyjlindesén dhé Mèmen é Drites...* » dhé kendohét :

Kênge IX.

Engjejte, dyké pare ngjitjén é Zotit, çuditëshin, si u-ngrit mé lavdè préj dhéut me te lartat.

O dhurata permi kupetim ! O myshtér i tmérrshim ! Si Zoti i te gjithévé, dyké shkuar préj dhéut ne qiéllorét, u dergoj Dishépujvé Shpirtin Shénjt, qe u ndriçoj mendjén dhé i bëri te ziarrte mé hir.

Engjejte, dyké pare...

Zoti i tha tufes se Dishépujvé : Ju rrini ne Jérusalém, dhé une do t' ju dergoj nje tiater Ngushellimtar, te bashkefronëshmin dhé te bashkendéruarin mé mua, qe me shikoni te shéstjohém mi nje ré te ndriçimé.

Engjejte, dyké pare...

Madheshtia é te varferuarit truperisht u-ngrit shéshit persiper qiéjvé, dhé natyra jone é rêne ndérohét mé bashkendenjién é Atit. Lé te krémterojme pra, lé te brohoritim te gjithë mé nje zê, dhé lé te trokasim duarte mé gas.

Hyjlindesoré. — Drita qe shkelqén préj drité, ô é panjollëshmé, lindi préj téjé, dhé perndau tère érresiren é athéismit, dhé ndriçoj atà qe flénin ne nate; perandaj

te gjithë, si pas détyres, te lumerojme gjithenjë për jëtë.

Zbritesoré. — Gezohu, ô Mbréteréshe, ô lavdì nënevirgjeroré; sé asnje gojë që flét, sadô é mirlevizur dhé é êmbel-fialte, nukë munt të të këdojë si të ka hié; dhé ç' dô mëndjë vertikohét të kupetojë lindjén tëndé Perandaj më një zê të lavderojmë.

Dergimesoré. — T. II.

Dyké shikuar Dishépujte, u-shéstjové, ô Krisht, dhé ndenjé bashkë më Atin; Engjëj réntnin përpara dhé therrisnin : Çélini dyërte, çélini; sé Mbréti u-ngjit prapë të laft' i kryëndriçim (*tri hère*).

Lavderimé. — T. I. — Pas «Ton uranion tagmaton».

Engjellorisht lé të krémtojme në të botëshmit Pérendinë tërë që rri më fron lavdié, dyké bertitur hymnin : I shénjte jé, ô Ate i qiëlleshmë, ô Fial' é bashkamëshuar, i shénjte jé, édhtë ti, Shpirti tëreshénjt.

Kur pane kréret é Engjëjvé, ô Shpetimtar, çudin' é Shéstjés s' até, njëri tiatrit i thoshin : Ç' është këjo pamjë dhé cili është këy, që dukét nga fytyra si njëri, dhé përsiper qiéjvé, si Pérendì, ngjitét më trupin é tij ?

Galiléanet kur pane që u-shéstjové të préj malit të Ullinjvé më gjithë trupin, ô Fiale, degjonin Engjëj që u thoshin atyrévé : Përsé shikoni dhé çuditëni? Kë do të vijë prapë truperisht, sikunder é pate më dhé.

Lavdì é Tanì. — T. T. II. — Lindé, siç déshé véte... (Shih më sipër nër Pasvargjét é Mbrêmesorés).

NE MËSHE

Antifon. — Shpetô-na, ô i Biri i Pérendisë, që u-shéstjové préj nësh nër qiéjte më lavdì, në që të këdojmë. Alleluia.

Hyrtoré. — U-ngjit Pérendia më brohori, Zoti më zê

trumbété. Shpetôna, ô i Bir' i Pérendise, qe u-shéstjové
préj nésh ner qiéjte mé lavdi...

Perleshorja dhé Shkurtorja é Shéstjés, dhé pastaj «*Shent Pérendi*»

APOSTULL

Ngjitu mi qiéjte, ô Pérendi.

Zemra imé eshte gati, ô Pérendi.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

Fialen é pare, ô Théofil, é bêra per te gjitha sa nisi Jésuj te bëje dhé te mesoje gjér m' atê dite qe u-shéstjua, passi mé anen é Shpirtit Shénjt u lâ porosira Apostujvé qe pat zgjédhur. Te cilevé u dehtëu dhé vétén é tij te gjalle, passi pesoj, mé shume shenja, dyké u-dukur ner tà per dyzét dite, dhé dyké u folur per punet é mbréterise se Pérendise. Dhé dyké qène mblédhur, i porositi mos ndahén nga Jérusalémi, po te présin zotimin é Atit qe degjuat préj méjé. Sé Joani pagezoz mé uje, po ju do te pagezohéni mé Shpirt Shénjt jo pas shune ditsh qe sot. Kur u-mblodhe pra, é pyésnin dyké thêne : «*Zot, valle me ketê kohe do t' i réstorosh mbréterine Israélit?*» Dhé ay u tha. «*Nuk eshte puna juaj te njihni koherat é motét qe i ka vène Ati ne potére te tij. Po do te mérrni fuqì, kur te vije Shpirti Shénjt mi ju; dhé do t' me jini deshmore ne Jérusalém dhé ne tère Judène dhé Samarine, édhé gjér ne funt te dhéut*». Dhé si tha ketô, ték po shikonin, u-ngrit, dhé nje ré é mori préj syvé te tyré. Dhé, ték po ishin dyké shikuar ne qiéll qe po shkonté, já dy njéres mé roba te bardha u qendruan afer, te cilet u thane : «*Burra Galiléane, persé qendroni dyké shikuar ne qiéll? Gjithe ky Jésu, qe u-shéstjua préj jush ne qiéll, do te vije prape ashtu siç é pate te shkojne ne qiéll*». Ahéré u-kthyén ne Jérusalém préj malit qe quhét i Ullinjvé, qe eshte afer Jérusalémit dhé mban nje te Shtune udhe lark.

UNGJILL

(Thuhét Ungjilli Mengjézor VI).

Ne « *Vêçan Têreshenjen* » thuhét Zbritesorja IX.

Kungatoré.

U-ngrit Pérendia mé brohorì, Zoti mé zê trumbété.

Ne vent te « *Pame driten* », thuhét Perleshorja é Shéstjés.

E DIÉLA É ATERVÉ

NE MBRÊMESORÉ

Thirrtoré.

Thuhén tri Vargezimé te T. T. II, tri te Shéstjés dhé ketô kater te Shen Atervé :

T. T. II. — Lindé préj gjiri para Dritesiéllesit, préj Atit pa nêne para jêtevê, mé gjithë qe Ariosi te kujton per kriatyre dhé jo per Pérendi, dyké te bashkuar mé nje guxim te çmendur ty Krijétarin mé kriésat, dhé dyké thésaruar per vétén é tij lênde ziarri te perjéteshme ; po Sinodi i Niqése te leçiti Bir Pérendié, ô Zot, te bashkefroneshme mé Atin dhé mé Shpirtin.

Cili t' a ndau kemishem, ô Shpetimtar? Ariosi qe mbylli syte per te mos shikuar driten, dhé te cilit i çirén mushkerite mé krép te hyjeshme dhé jép shpirt ne mundimé si tiater Jude nga mendja dhé nga menyra ; po Sinodi i Niqése te leçiti Bir Pérendié, ô Zot, te bashkefroneshme mé Atin dhé mé Shpirtin.

Ariosi i çmendur préu monarqine é Trinise se têreshénjte me tri qênié te ndryshmé dhé te ndara ; perandaj Aterit hyjprures, te mblédhur mé gjithë zemer, dhé te ndézur mé zéll si Thésbiti Elia, présin mé shpaten é Shpirtit blasfémorin é turpit qe dogmatisoj, sikunder i dha funt Shpirti.

Lavdi. — *T. T. II.* — Lé te perlevdojme sot trumbétat myshtiké te Shpirtit, Aterit hyjprures, qe kenduan ne més te Kishes nje kênge harmoniozé préj théologié, nje Trini te pandryshuar, nje qênié, dhé nje Hyni, rrezonjesit é Ariosit, dhé perluftaret é Orthodoxevé, qe ner-

mjétojne gjithenje té Zoti qe te meshirohén shpirtét tona.

Tanì. — Cili do mos te lumeroje, ô Hyjllindésé Virgjé-réshe ?...

Pasvargjé.

Kater Pasvargjét é Tingellit T. II.

Lavdi. — *T. IV.* — Kujtimin é permoteshme te Atervé hyjprures, qe u-mblodhe préj tête botes ne qytét te shkelqyer te Niqése, dyké ndéruar zakonét é Ortho-doksevé, lé te krémterojme sot béserisht. Sé ketà rrezuan piozerisht doktrinen é pabése te Ariosit te tméruar dhé é ostraqisne sinodikerisht nga Kisha Katholiké; dhé mé zê te larte i mesuan te gjithë te rreféjne Birin é Pérendise te bashkeqênurshme, te bashkaméshuar, dhé te lindur para jétevé, dyké é çponuar pikerisht dhé piozerisht té Symbol' i béses. Perandaj dhé né, dyké vajtur pas dogmavé te tyré te hyjeshmé, mé bése te shigurte adhurojme Birin dhé Shpirtin tëreshénjt mé Atin, si Trinì te bashkeqênurshmé me nje Hynì.

Tanì. — O Zot, si mbarové myshtérin é fshéhur qe préj jétesh dhé préj brézash, si i mire, ardhé mé Dishépujt é tû ne mal te Ullinjvé, dyké patur até qe te lindi ty, Béresin dhé Krijétarin é te gjithavé; sé ajò qe vuajti nënerisht më téper sé te gjithë per pesimin tënt, duhéj te gezonté nje gas te stermath me lavdin' é trupit tënt; nga i cili piésetojme dhé né me ngjitjén tëndé ner qiéjte, ô Zot, dhé lavderojme perdellimin é math qe na u-dha.

Perleshoré. — *T. T. IV.*

Mê pare é T. T. II, pastaj kjò é Atervé :

I permilavderuar jé, ô Krisht Pérendia jone, qe thé-mélové permi dhéne si yj Aterit tane, dhé mé anen é tyré na hoqé udhen te gjithëvé té bésa é vertéte, lavdi me ty.

TANI : Thuhét Perleshorja é Shéstjés.

NE MENGJËS

Ndenjesoré, Degjim, dhé Shkallésa te T. T. II.

Shkurtoré. — T. T. IV.

Leçitja é Apostujvé dhé dogmat é Atervé i forcuan Kishes bésen é njeshmé; é cila dyké mbajtur kemishen é se vertétes, te éndur préj théologise se sipermé, prêt dréjterisht dhé lavderon myshtërin é math te piététit.

Shpia.

Lé te degjojme Kishen é Pérendise qe therrét mé leçitjé te larte : Ay qe ka étyé lé te vije dhé lé te pije; kratéri qe mbaj eshte kratér urtesié; pirjén é tij é perziéva mé fialen é se vertétes, dyké dérdhur uje rrefimi dhé jo kundreshtimi; nga é cila pi Israéli i tanishme dhé shikon Pérendine qe flét : Shikoni, shikoni qe une véte jam dhé nuk jam ndrruar, une Pérendi' é pare, une dhé i pastajmi dhé véç méjé s' ka tiater faré. Atà qe piésetojne préj keti do te nginjén, dhé do te lavderojne myshtërin é math te piététit.

Synaksar.

Gjithe sot, te Diëlen é Shtatte pas Pashkes, krémterojme Sinodin Ekuménik te pare te Niqése préj tré qint é tétembedhjéte Atervé hyjprur es. Te pollit mendor yj driteprures, Mé rézét tuaja ndritmani mendjén.

Kunder Ariosit.

*Qofte jashte laftit pérendor Ariosi,
Qe thote sé Krishti qé jashte qéniés s' Atit.
Mé nermjétimét é tré qint é tétembedhjéte Shen Atervé hyjprures
ó Krisht Pérendia jone, meshiró-na. Amen.
Zbritesoré te Shéstjés, Ungjill Mengjézor I, « Mé te ndërçimén »*

Dergimesoré.

Mé pare Dergimesorja I, pastaj kjò é Atervé :

E Atervé te hyjeshme sot krémterojme kujtimin, dhé

mé urimét é tyré te lutémi, ô i meshireshme : Shpetô popullin tént préj ç' dô dêmi hérézirash, ô Zot, dhé na vléresô te gjithë te lavderojme Atin, Birin, édhé Shpirtin tëreshénjt.

Pastaj Dergimesorja é Shéstjés.

Lavderimé.

(Per Lavderimét dhé Lavdine shih té Libra é te Krémhtëvé te Medha, f. 28-29).

NE MÉSHE

Ne Hyrjë thuhén Perleshorja é T. T. II, pastaj é Shéstjés, pastaj é Shen Atervé dhé Shkurtorja é Shéstjés.

APOSTULL

I békuar jé, ô Zot, Pérendì é Atervé tane.

Sé jé i dréjte me te gjitha sa na béré.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

M'atô dite, Pauli é pâ mé udhe te lundroje neper ane te Eféses, per te mos humbur kohen ne Asì; sé nxitonté te gjéndéj, po te muntté, ne Jérusalém ditën é Rushajés. Dhé dergoj préj Milétes ne Efése dhé thirri pléqt' é Kishes. Dhé kur ardhe ték ay, u tha : « Kini kujdés per vétén tuaj dhé per tëre grigjen, mi te cilen Shpirti Shénjt ju vuri pëshkope per te kullotur Kishen é Pérendise te cilen é fitoj mé gjakun é tij. Sé une é di ketê, sé pas ikjés s' imé do te hyjne ner ju ujqer te keqij pa kursyér grigjen. Edhé préj jush véte do te ngrihén njéres, dyké folur gjëra te shtrembera, qe te terhéqin dishépujte pas vétés se tyré. Perandaj vigjelloni, dyké kujtuar qe tré vjët nuke pushova nat' é dite se keshilluari mé lot sicilindô. Edhé tanì, ô vellézer, ju pranoj té Pérendia dhé té fiala é hirit te tij, i cili munt t' ju ndertoje dhé t' ju jape trashëgim, ne més te gjithë te shénjteruarvé. Nuke desherova ar, a argjent, a

pétka te asnonjejt. Edhé ju véte é dini qe per névojat é mia dhé per atà qe ishin mé mua kane sherbyér ketò duart' é mia. Te gjitha ju' a deftova, sé keshtu, dyké u-munduar, duhét t' i perkrahni te dobetit, édhé te kujtoni fialet é Zotit Jésu, sé ay tha : Eshte më é lumur te japesh sé sa te marresh ». Edhé si tha ketò, ra me gjunje dhé u-fal mé atà te gjithë.

UNGJILL. — PAS JOANIT.

M'atê kohe, ngriti Jésuj syt' é tij ne qiéll, dhé tha : « Ate, ardhi ora; lavderô t' et-Bir, qe dhé yt-Bir te te lavderoje; sikunder i dhè potére mi ç' dô trup qe t' u jape jéte t' amëshuar te gjith' atyrévé qe i ké dhêne. Edhé kjo eshte jét' é amëshuar, qe te njohin ty, te vétemin Pérendì te vertéte, dhé Jésu Krishtin qe ké derguar. Ua çfaqa émerin têt njéresvé, qe me dhè préj botes; ishin te tute, dhé m' i dhè mua, édhé fialen tëndé é kane mbajtur. Tanì muare vésh qe te gjitha sa me ké dhêne jane préj téjé; sé fialet qe me ké dhêne ua dhashe; dhé atà i muare dhé muare vésh mé te vertéte qe kane dale préj téjé dhé bésuan qe ti me ké derguar. Une per ketà lutém; nuke lutém per boten, po per atà qe me ké dhêne, sé jane te tute. Edhé gjithë te miat jane te tuat, édhé te tuat te miat, dhé jam lavderuar ner tô. Dhé tanì nuke jam më ne bote, po ketà jane ne bote, dhé une vij té ty. Ate i shénjte, ruaj-i me émerin têt atà qe me ké dhêne, qe te jéne njê, si né. Kur isha mé tà ne bote, i ruanja une me émerin têt; atà qe me ké dhêne i ruajta, dhé asnje préj syrësh nuke humbi, pervéç sé Bir' i humbjés, qe te mbushét Shkriptura. Dhé tanì vij té ty dhé ketò i flas ne bote, qe te kéne gazin t' im te mbaruar ner tà ».

Ne « *Véçan Têreshênjtem* » thuhét « *I ka hié më te vertët* » Kungatorja é zakoneshmé é se Diélavé. Ne vent te « *Pame Driten* » thuhét Perleshorja é Shéstjés.

RUSHAJÉT

NE MBRËMESORÉ

Thirrtoré.

T. I. — Krémterojme Rushajét, dhé ardhjén é Shpirtit, dhé ditén é zotimit dhé mbarimin é shpréses; dhé sa myshtér i math dhé i ndéruar ! Perandaj po te therrésim : O Zot, krijétar i gjithesise, lavdì me ty (*dy hére*).

I perserité mé gjuhera te huaja Dishépujt é tû, ô Krisht, qe mé anen é tyré te leçitin ty, Fialen é pavdékur dhé Pérendì, qe u fal shpirtévé tona perdellimin é math.

Te gjitha i fal Shpirti Shénjt; buron profétira, mbaron prifterij, u meson te paditurvé urtesì, i bèn pëshkataret théologe, permbléth tête kanunin é Kishes. O Ngushe-llimtar, i bashkeqênurshme dhé i bashkefroneshme mé Atin é mé Birin, lavdì me ty.

T. II. — Pame Dritén é vertéte, muarrme Shpirtin qiéllor, gjétme bésen é vertéte, dyké iu-falur Trinise se pandare; sé ajò na shpetoj (*dy hére*).

Ner Profétet na lajmerové udhen é shpetimit, dhé ner Apostujte ndriti hir' i Shpirtit tént, ô Shpetimtari yne; ti jé Pérendi' é pare, ti jé dhé i pastajmi, dhé ti jé Pérendia jone per jéte.

Ner hoborrét é tua do te hymnoj ty, Shpetimtarin é botes, dhé, dyké u-pergjunjur, do t' adhuroj fuqine téndé te pamundurshmé, mbrëmané dhé ne mengjés dhé ne mésdite, dhé me çdò kohe do t' te békoj, ô Zot.

Né bésniket, ô Zot, dyké unjur gjunjét é shpirtit dhé te trupit, perhymnojme ty, Atin é paniseshme, dhé

Birin é bashkepaniseshme, édhé Shpirtin tëreshénjt dhé te bashkamëshuar, qe ndriçon dhé shénjteron shpirtét tona.

Lé te perhymnojme Trinin' é bashkeqênurshmé, Atin, édhé Birin, édhé Shpirtin Shénjt; sé keshtu leçitne gjithë Profétet dhé Apostujte mé Deshmoret.

Lavdi é Tanì. — T. T. IV. — Ejani, ô popuj, t' adhurojme Hynin' é triqênurshmé, Birin mé Atin é mé Shpirtin Shénjt; sé Ati lindi pa mot Birin é bashkamëshuar dhé te bashkefroneshme, dhé Shpirti Shénjt ish ték Ati, i lavderuar mé Birin, nje fuqì, nje qënié, nje Hynì, te cilen é adhurojme te gjithë dhé thomi : Shénjt Pérendì, qe krijové te gjitha mé anen é Birit, mé bashkepunimin é Shpirtit Shénjt, Shénjt i Fuqishme, mé anen é te cilit kémi njohur Atin édhé Shpirti Shénjt ardhi ne bote. Shénjt i Pavdékur, Shpirti Ngushellimtar, qe dergohét préj Atit, dhé çlodhét me Birin, Trinì é shénjte, lavdi me ty.

Pasvargjë. — T. T. II.

Kombét, ô Zot, dyké mos ditur fuqin' é Shpirtit Shénjt qe u árdhi Apostujvé te tû, é kujtonin per déhjé foljén é shume gjuhevé; po né, te pshtétur préj syrësh, keshtu thomi pa pushuar : Te lutémi, mos mérr préj nësh Shpirtin tënt te Shénjte, ô njéridashes.

Vark. — Krijó zemer te kthiëllet ték une, ô Pérendì, édhé perserit perbrenda méjé Shpirt te dréjte.

O Zot, ardhja é Shpirtit Shénjt i frymesoj Apostujt' é tû dhé i gatiti te flasin me gjuhera te tiéra; perandaj kjò çudi u dukéj déhjé te pabésevé, dhé bésnikevé shkaketaré shpetimi; per ndriçimin é te cilit na vléresô dhé né, te lutémi, ô njéridashes.

Vark. — Mos me hith téj préj faqés s' até, édhé mos mérr préj méjé Shpirtin tënt te Shénjte.

Mbrét qiëllor, Ngushellimtar, Shpirt' i se vertétes, qe

ndodhësh kudô dhé i mbush te gjitha, thésar i te miravé, dhé fales i jétes, éja dhé téndesô ner né, dhé spastrô-na préj ç' dô njollé dhé shpetô, ô i mire, shpirtét tona.

Lavdi é Tanì. — *T. T. IV.* — Gjuhët nje hère u-perzién nga kuximi i ndertimit te tures; dhé tanì gjuhët u-urtesuan nga lavdia é Hyjnjuhjés. Atjé Pérendia denoj çpiétozet per fajin; ketu Krishti i ndriti pëshkatarët mé Shpirtin. Ahéré néméceria u-véperua per punitjé; dhé tanì perserité marrevëshja per shpetim te shpirtévé tona.

Perleshoré. — *T. T. IV.*

I békuar jé, ô Krisht Pérendia jone, qe i trégové pëshkatarët te gjithurte, dyké u derguar Shpirtin Shénjt, dhé mé anen é tyré riétové tère boten; njéridashes, lavdi me ty (*tri hère*).

NE MENGJÉS

Ndenjesoré.

T. IV. — *Pas « Katéplagi Iosif ».* — Lé te krémtojme gazmorisht paskrémtén é fundit sot, ô bésnike, lavderisht; sé Rushaja eshte kjô, qe mbaron zotimin édhé kohën; sé tanì zbrét posi ziarr Ngushellimtari permi dhé, nene forme gjuherash, dhé Apostujte i ndriçon, dhé i trégon dishépuj qiéllore. Ardhi drita é Ngushellimtarit édhé ndriti boten (*dy hère*).

(*Gjith' ashtu*). — Burim' i Shpirtit Shénjt sot na zbriti permi dhé, ner te ziarreshme lumenj é perndare menderisht, dhé i vésoj mé drite Apostujte; édhé ziarri permi tà si ré préj vésé u-bê, dhé i ndrit dhé i meson, flaga qe bié si shi, préj te cilevé muarme hirin mé ane ziarri dhé ujé. Ardhi drita é Ngushellimtarit, édhé ndriti boten (*dy hère*).

T. T. IV. — *Pas « To prostahthén si ».* — Pas Ngjalljés

s' até, ô Krisht, préj varrit, dhé pas Shéstjës pérendoré lart ner qiéjte, u çové hyjpamesvé laftin tënt, i zemerdhêmpshur, dhé Shpirt te dréjte Dishépujvé u perserit; perandaj u thirrë te gjithëvé mé zê math, posi qithare é muzikeshmé mé pende pérendoré myshtikerisht tingellimét, ô Shpetimtar, dhé urdherimin tënt (*dy hère*).

Qe préj dialerise s' imé...

Parevark.

Shpirti yt i mire do te me héqe me udhe dréjtesié.

Vark. — O Zot, degjô te falurit t' im.

UNGJILLI Mengjézor IX dhé mé nje hère Psalmi 51 pa zê.

Lavdi. — Mé nermjétimét é Apostujvé...

Tani. — Mé nermjétimét é Hyjlindesés...

Vark. — *Perdellyes, perdellé-me...*

T. T. II. — Mbrët qiëllor, Ngushellimtar... (*Shih ne Mbrêmesoré mé sipër.*)

Shkurtoré. — *T. T. IV.*

Kur zbriti dhé perziéu gjuherat, i perndau kombét i Larteri; dhé kur perndau gjuherat é ziarrit, i thirri te gjithë ne bashkim; dhé mé nje zê po lavderojme Shpirtin é têreshénjte.

Shpia.

Ngushellim te shpéjtme dhé te qendruarshme ép-u sherbetorevé te tû, ô Krisht, kur frymerat tona ndodhén ne névéritjé; mos u-ndaj préj shpirtévé tona ner hidherimé, mos u-largô préj mendjévé tona ner rasjéra, po na arrì gjithenje. Afronaju, afronaju, ti qe ndodësh kudô; siç ishë gjithenje mé Apostujte, ashtu bashkohu dhé mé né qe te te duam mé mall, ô meshireplot, qe te te hymnojme, te lidhur mé ty, dhé te lavderojme Shpirtin tënt te têreshénjte.

Synaksar.

Gjithe sot, te Diëlen é Tétte pas Pashkes, krémterojme Rushajët é Shénjta.

Mé fryrjë te rrëpte préj gjuherash ziarri

U perndan Krishti Shpirtin Shénjt Apostujvé.

Shpirti u dërdhét pëshkatarevë ne nje dite te madhé.

Mé nermjëtimët é Apostujné te shénjte, ô Krisht Pérendia jone, meshirô-na. Amen.

Zbritesoré. — T. i Rênde.

Kendohét kjò mé poshte mé atê te Shéstjés bashke :

I. Ne dét é mbuloj Faraonin mé qérét ay qe dermon armiqtë mé krahun é tij te larte. Ati lé t' i kendojme, sé u-lavderua.

III. Rrini ne Jérusalém gjér sa te vishéni mé fuqine qe lartazi, u thé Dishépujvé, ô Krisht; dhé une do t' ju dergoj nje tiater Ngushellimtar si mua, Shpirtin t' im dhé te Atit, me te cilin do te shigurohéni.

IV. Dyké kupetuar Proféti, ô Krisht, ardhjén tëndé me kohen é fundit, therristé : Kam degjuar potéren tëndé, ô Zot, sé ké ardhur te shpetosh gjithe te lyérit é tû.

V. Shpirti i shpetimit, qe u-zû ne bark te Profétevé nga frika joté dhé lindi mi dhéne, paqeson zemrat é Apostujvé dhé perserit dréjterî ner bésniket; sé urdheratat é tua jane drite dhé paqe.

VI. I andralluar préj shqotes se kujdésévé te jétes, i zhytur préj mekatësh kuplévatesé, dhé i hédhur té égersira shpirt-prishesé, si Jonaj po te therrés, ô Krisht : Nxir-me jashte préj thëllesires vdékjëpruresé.

VIII. Diémat oshenare qe u-hodhe ne furre te ziarrit, é ndrruan ziarrin me vése mé kênget é tyré, dyké thirrur keshtu : I békuar jé, ô Zot, Pérendi' é Atervé tane.

VIII. Férra é padiégur nga ziarri, qe foli ne Sinà, i bëri te njohur Pérendine Moisiut belbecak dhé te lik-zëshme; dhé zéll' i Pérendise trégoj te pangadhenuar

préj ziarrit tré Diémat qe kendonin : Gjithe véprat, hymnoni Zotin dhé é permilartesonî per gjithe jétet.

Kênge IX.

« O Nên' é pamarrtuar dhé Hyjlindesé Virgjeréshe, qe lindé pa pesuar prishjé dhé i hové trup Fiales, Miéshterit te gjithesise, ô éne é te pakulmetit dhé are é Gatonjesit têt te paaneshme, ty te madhestojme ».

I hipur mi qéré te ziarrte qe flagesonté, zélloti dhé i frymeziarriti nje hére u trégonté mé gas qe lartazi Apóstujvé frymesimin qe shkelqén tanì, préj te cilit te ndrìquar ua bène te njohur Trinine te gjithévé.

Gjë é çudiçimé permi kanunét é natyres u-degjua; sé zèri i dishépujvé mé hir te Shpirtit tingelliu me gjuhera te ndryshmé, dhé kombé, popuj, édhé fisé degjonin madheshtirat é hyjeshmé te Trinise.

T. IV. — « Gezohu, ô Mbréteréshe, ô lavdì nène-*virgjeroré*; sé asnje goje qe flét, sadô é mirlevizur dhé é êmbelfialte, nuke munt te te kendoje si te ka hié; dhé ç' dô mendjé vértikohét te kupetoje lindjén tëndé. Perandaj mé nje zê te lavderojme ».

U-pâ é udhes te mbétét mé barre Vajza jétepruresé; sé ajò vétém fshéhu ne gji Fialen, qe sheroj natyren é semure te njéresvé; i cili, i ndenjur tanì me anen é diathte te Atit, dergoj hirin é Shpirtit.

Atà, qe u ndrìti hir' i riédhur préj Pérendié, shkelqyén, vétetitne, dhé u-ndrruan mé nje ndryshim te çudiçim é te mirhieshme. Dyké ditur qe qènia é urte tridritoré esht é njefuqishmé dhé é paprère, po é lavderojme.

ZBRITESORÉ { « O Nên' é pamarrtuar...
« Gezohu, ô Mbréteréshe... »

Dergimesoré. — T. III.

O Shpirt i tèreshénjte, qe dergohésh préj Atit, dhé qe zbrité mé anen é Birit mi Dishépujt' é paditur, shpetô

dhé shénjterô te gjithë sa te njohin per Pérendi (*dy hère*).

Drite Ati, Drite Fiala, Drite édhé Shpirti Shénjt, qe u-dergua mi Apostujte posi gjuhera ziarri; dhé mé tê ndriçohét tère bota te ndéroje Trinin' é shénjte.

Lavderimé. — T. IV.

Persedytén qe te tria ketô :

Gjêra te çudiçimé pane gjithë kombét ne qytét te Davidit, kur zbriti Shpirti Shénjt ner gjuhera ziarri, siç tha Hyjfolesi Luka. Sé thote : Ték ishin mblédhur Dishëpujt' é Krishtit, ardhi nje oshetim, si nje fryrjé é répte qe silléj, dhé mbushi shtepine, ku ishin dyké ndenjur; dhé te gjithë nisne te flasin fiale te huaja, doktrina te huaja, mesimé te huaja, te Trinise se shénjte.

Shpirti Shénjt ish gjithenje dhé eshte dhé do te jéte, nuke nisi dhé as do te pushoje, po gjithenje esht i urdheruar dhé i numeruar bashke mé Atin é mé Birin; i mire véte dhé burim miresié, mé anen é te cilit njihét Ati dhé lavderohét Biri dhé préj te gjithëvë dihét nje fuqì, nje urdher, nje adhurim i Trinise se shénjte.

Shpirti Shénjt eshte drite dhé jéte dhé burim i gjalle mendor; Shpirt urtesié, Shpirt mençimerié, i mire, i dréjte, mendor, zoteror, spastronjes i fajévé; Perendì dhé hyjesonjes; ziarr qe buron préj ziarri, qe flét, véperon, dhé ndan dhuretira; mé anen é te cilit gjithë Profétet dhé Apostujt' é Pérendise mé Deshmoret u-kurozeruan. Lajm' é çudiçimé, pamjë é çudiçimé, ziarr qe perndahét ner piésa dhuretirash.

Lavdì é Tanì. — T. T. II. — Mbrét qiëllor, Ngushellimtar...

NE MËSHE

Antifon. Shpetô-na, ô Ngushellimtar i mire, né qe te therrésim : Alleluia.

Hyrtoré.

Lartesohu, ô Zot, mé fuqine tëndé; do te kendojme
dhé do te psallim potérat é tua.

Shpetô-na, ô Ngushellimtar i mire...

Perleshoré dhé Shkurtoré é Rushajévé. Ne vent te « *Shénjt Pérendi* »,
thuhét : « *Sa u- pazezuat me Krishtin* ».

APOSTULL

Mi tère dhéne dolli fiala é tyré.

Qiéjte trégojne lavdè Pérendié.

Kendimi préj Aktévé t' Apostujvé.

Veprave

Dhé kur ardhi ploterisht dita é Péседhjétorés, ishin
te gjithë Apostujte mé nje zemer me nje vent. Dhé
béfas ardhi nje oshetim préj qiéllit si préj nje éré te répte
qe frynté, édhé mbushi tère shtepine, ku ishim dyké
ndenjur. Edhé u-dukne me tà te ndara gjuhera posi te
ziarra, édhé ndenjne mi sicilindô préj syrësh, dhé
u-mbushne te gjithë mé Shpirtin Shénjt, édhé nisne te
flasin gjuhera te tiéra, siç ua jépté Shpirti te ligjerojne.
Edhé ishin dyké ndenjur ne Jérusalém Judéj, burra
bésetare préj çdô kombi qe gjéndén nene qiéll. Dhé kur
u-perhap ky zê, u-mbloth gjindja édhé u-perzié, sé cilidô
i degjonté te flasin ne gjuhen é tij. Edhé te gjithë shtan-
geshin é çuditeshin, dyké i thêne njêri tiatrit : « Shih,
nuke jane Galiléas te gjithë ketà qe po flasin? Dhé si
né i degjojme sicilidô ne gjuhen tone, ne te cilen kémi
lindur? Parther é Méder, Elamiter dhé atà qe banojne
Mésopotamine, Judéne dhé Kappadoqine, Pontin dhé
Asine, Frygine dhé Pamfylene, Egypten dhé visét é
Libise prane Qyrénes, dhé te huajte Romane, Judéj
dhé proséliter, Krétas dhé Araber, i degjojme te flasim
me gjuherat tona madheshtirat é Pérendise ».

UNGJILL. — PAS JOANIT.

Me ditën é funtmé te se Krémtés se madhé, qendroj Jésuj dhé thirri, dyké thêne : « Ne ka étjé nonje, lé te vije té mua, dhé lé te pije. Ay qe béson té mua, siç tha Shkriptura, lumenj préj ujé te gjalle do te riédhin préj barkut te tij. (Dhé ketê é tha per Shpirtin, qe do te mérrnin atà qe é bésonin; sé êdhé s' ishtë dhêne Shpirti Shénjt, sé Jésuj êdhé s' ishtë lavderuar.) Shume pra préj gjindjés, kur degjuan ketê fiale, thoshin : « Ky eshte mé te vertéte Proféti. » Te tiére thoshin : « Ky eshte Krishti. » Edhé te tiére thoshin : « Mos vjén préj Galilése Krishti? Nuke tha Shkriptura qe Krishti vjén préj fares se Davidit dhé préj katundit Béthléhém, ku ish Davidi? » U-bé pra nje çarjé ne gjindjén per tê. Dhé ca préj syrësh déshnin t' a zinin; po asnje nuke vuri duarte mi tê. Ardhe pra sherbetoret té Kryépriftijte dhé Farisianet. Dhé ketà u thane : « Persé nuk é prute? » U-pergjéqne sherbetoret : « Kurre s' ka folur njéri si ky njéri ». U-pergjéqne Farisianet : « Mos u-genjyét dhé ju? Mos i bésoj nonje préj krérevé, a préj Farisianevé? po kjò gjindjé, qe nuke di ligjen, esht é mallkuar. » U thote Nikodémi, i cili i kish ardhur naten, dhé ish nje préj syrësh : « Mos ligja jone é gjukon njérine, ne mos degjofte më pare préj tij, dhé te marre vésh ç' bèn? » U-pergjéqne dhé i thane : « Mos jé dhé ti préj Galilése? Nxonit é shih qe profét préj Galilése nuk eshte ngritur ». U foli pra perserì Jésuj dhé u tha : « Une jam drita é botes. Ay qe me vjén pas, nuke do te barése n' érrësire, po do te kéte driten é jétes ».

Ne « *Vëçan Têreshénjten* » thuhét Zbritesorja IX : « *O Nën' é pamarrtuar* ».

Kungatoré.

Shpirti yt i shénjte do te me héqe udhen mi dhè dréjtesié.

Ne vent te « *Pame Driten* », thuhét Perleshorja é Rushajévé.

SHERBËSA É MBRËMESORËS SE MADHË

Pas Méshes nis mé nje hére Mbrëmesorja. Pas Psalmit Nistor, thuhét préj Diakut a préj Priftit kjò LITANI É MADHË :

Me paqe Zotit lé t' i lutémi.

Per paqen qe lartazi dhé per shpetimin é shpirtévé tona, Zotit lé t' i lutémi.

Per popullin qe rri rrotull dhé prêt hirin é Shpirtit Shénjt, Zotit lé t' i lutémi.

Per atà qe unjin perpara Zotit zemrat dhé gjunjet é tyré, Zotit lé t' i lutémi.

Qe te forcohémi per mbarim mirpelqimi, Zotit lé t' i lutémi.

Qe te dergohén mi né meshirat é tij te pasura, Zotit lé t' i lutémi.

Qe te pritét pergjunjia jone, si témian perpara tij, Zotit lé t' i lutémi.

Per atà qe kane névoje per ndihme préj tij, Zotit lé t' i lutémi.

Qe te shpetohémi préj ç' dô hidherimi...

Perkrah-na, shpetô-na...

Têreshénjten, te pacinuaren...

Sé ty te ka hiéç' dô lavdì, ndér, dhé adhurim, Atit, é Birit, édhé Shpirtit Shénjt, tani é perhére, dhé ne jéte te jétevé. Amen.

Ne Thirrtorét kendohén Vargezimét dhé Lavdia é Lavderimévé (*Shih më sipër*). Hyrjé mé témianice, « *Drite gazmoré* » dhé PAREVARK :

T. I. Rênde. — Cila Pérendì esht aq' é madhé sa

Pérendia jone? Ti jé Pérendi' é vétém qe bèn çudira.

Pastaj thote DIAKU :

Perserì dhé perserì, dyké rêne me gjunje, Zotit lé t' i lutémi.

Bésniket bién me gjunje, dhé Prifti kendon préj Tribunes mé zê te larte ketô URIMÉ :

O Zot i panjollëshme, i pacinuar, i paniseshim, i padukur, i pakupetuarshim, i pagjurmesuar, i pandryshuar, i papershkruar, i pamatur dhé ké qduronjes, i vétëmi i pavdékshim, qe banon ne drite te paaferuarshmé, qe bêré qiéllin, dhéne, détin dhé gjithë te krijuarat ner tô, qe u fal kerkimét te gjithëvé para sé te te lypin, ty te lusim, é ty te lutémi, Zot njéridashes, At' i Zotit dhé Pérendise dhé Shpetimtarit tone Jésu Krisht, i cili per né njérezit dhé per shpetimin tone zbriti préj qiéjvé, dhé u-misherua préj Shpirtit Shénjt dhé gjithmonvirgjerës Marì dhé Hyjlindesés se lavderuar; i cili, dyké mesuar mé fiale më pare, dhé dyké tréguar mé pune pastaj, kur duronté Pesimin shpetimtar, na fali shëmbell ndepertimi névé sherbetorevé te tû te perunjur, mekatore dhé te pavyér te te blajtojme lutjé mé kryé dhé gjunje te unjur per mekatét tona dhé per padijat é popullit. Ti pra, ô meshireplot dhé njéridashes, degjô-na me ç' dô dite qe te te lutémi; dhé véçanerisht me ketê dite te Rushajévé, ne te cilen, passi u-ngjit lart ner qiéjte Zoti yne Jésu Krisht dhé ndenji me te diathten tëndé, ô Pérendi dhé Ate, dergoj mi Dishépujte dhé Apostujt' é tij te shénjte Shpirtin Shénjt, i cili qendroj mi cilindô préj syrësh dhé u-mbushne te gjithë mé hirin é tij te pazbrazur, dhé fole me gjuhera te tiéra madheshirat é tua dhé profétesuan. Degjô-na prâ tanì qe po te lutémi dhé kujtô-na né te perunjurit dhé te denuarit, dhé kthéj-é prape roberine é shpirtévé tona, dyké patur dashurine tëndé si nermjétaré per

né. Prit-na né qe po te biém ner kêmbe dhé te therrésim : Mekatuam. Mi ty jémi hédhur qe préj foshnjerise, qe préj barkut te nênes s'one; Pérendia jone ti jé; po, nga qe i shkuam ditet tona me kotesì, na é hoqé ndihmen tëndé dhé mbétme çvëshur, dhé na mungoj ç' dô apologi. Po, dyké marre kuraje nga dhempsherit' é tua, therrésim : Mekatét dhé padijat é dialerise s' one mos i kujtô, dhé spastrô-na nga te fshéhtat tona. Mos na çperhith téj me kohe te pléqerise; mos na névérit tani qe na humbi fuqia; para sé te kthéhémi ne dhé, vléresô-na te kthéhémi té ty, dhé vêr-na ré mé miredashjé dhé mé hir. Mbulô-i paligjesite tona mé dhempsherit' é tua; vêr kunder shumices se paudhesivé tona avushen é meshirimévé te tua. Hith syrin préj lartesise s' até se shénjte, ô Zot, mi popullin tënt qe rri rrotull dhé prêt meshiren é pasur préj téjé; veshtrô-na mé zemberardhesine tëndé; shpetô-na nga shtyrani' é Diallit; shigurojé jéten tone mé ligjat é tua te shénjta. Kushenójé popullin tënt té nje Engjell ruajtes bésnik; mblith-na te gjithë né ne mbréterine tëndé; dhuro-ju ndiése atyrévé qe shprésojne mi ty; fal-u atyrévé dhé névé fajét; spastrô-na mé véperimin é Shpirtit tënt Shénjt; perndaj-i intrigat é armikut kunder nësh.

Shton dhé keté Urim :

I békuar jé, ô Zot, ô miéshter i têrefuqishim, qe shkelqévé ditën mé dritën é diéllit, dhé buzeqéshé naten mé shkëndija ziarri; qe na vléresové te shkojme gjatesin' é dites dhé te aferohémi me nisjén é nates, degjoj-é lutjén tone dhé te popullit; dhé, si te na falsh te gjithëvé mekatét é dashura dhé te padashura, prit faljét tona mbrêmesoré, dhé dergô shumicen é perdellimit tënt dhé te meshiravé te tua mi trashegimin tënt. Muresô-na mé Engjejt é tû te shénjte; armatis-na mé armet é dréjtesise s' até; rréthô-na mé te vertéten

tëndé; ruaj-na mé fuqine tëndé; shpetô-na nga çdô rasjë dhé nga çdô këqdashjë é kundreshtarit. Fal-na dhé ketê mbrême mé naten qe vjén te mbare, te shénjte, te paqeshmé, te pamekateshmé, pa shkanduj dhé fandasma, si dhé gjithë ditet é jétes s' one; mé nermjétimét é Hyjlindesés se shénjte dhé te gjithë Shenjtorevé, qe te kane pelqyér qe préj jété.

DIAKU : Perkrah-na, shpetô-na, meshirô-na, ngrér-na dhé ruaj-na, ô Pérendi mé hirin tënt.

Têreshénjten, te pacinuaren...

PRIFTI : Sé ti na meshiron é na shpeton, dhé ty te dergojme lavdi, Atit...

DIAKU : Lé te thomi te gjithë...

PRIFTI : Sé ti jé Pérendi meshireploté dhé njëridashesé dhé ty...

DIAKU : Perseri dhé perseri, dyké rêne me gjunje, Zotit lé t' lutémi.

Dhé PRIFTI kendon ketê URIM :

O Zoti Jésu Krisht, Pérendia jone, qe u ké dhêne njëresvé paqen tëndé dhé u falé pergjithmone bésnikëve dhuraten é Shpirtit tëreshénjt si trashëgim te parrembyérshim, kur ishë ne jéte mé né, dhé qe u dergové sot më shëshit ketê hir Dishépujvé dhé Apostujvé te tû, dhé u vuré ne goje gjuhera te ziarrta, mé anen é te cilavé gjithë gjindja é njëresvé degjuam é njohme Pérendine cilidô me gjuhen é tij, dhé u-ndriçuam mé driten é Shpirtit, dhé u-çliruam nga rréjtja dhé nga érrësira, dhé mé perndarjén é gjuhevé te ziarrta dhé mé véperimin é perminatyreshme u-mesuam me bésen tëndé dhé me théologine tëndé bashke mé Atin é mé Shpirtin Shénjt, me nje Hyni, me nje fuqi dhe me nje potére u-shkendritme. Ti pra, shkelqim' i Atit, i pandryshuari nga natyra dhé nga qënia, karakter i paçvendosur, burim i shpetimit dhé i hirit, çélm-i buzet dhé mua mekatarit dhé mesô-me, si ka hié dhé per ç' névoja te lutém. Sé ti jé ay qe di shumicen é mekatévé te mia, po

dhempsheria jotë do t'a munde panumersine ë tyrë; së ja ku qendroj perpara tëjë më frike, passi hodha deshperimin ë shpirtit t' im të dëti i meshires s' atë. Qëverism'a jëten, ti qe qëveris tëre kriësen forterisht më fialen ë patrëguar te urtesise s' atë, ti, ô liman i qëte i dimerorevë, dhë trëgôm'a udhen qe do te barës. Fal-u mendimëvë te mia shpirtin ë urtesise s' atë; dhurô-i çmenderise s' imë Shpirt te mëçim; hijësô-i véprat ë mia më Shpirtin ë frikes s' atë; Shpirt te drëjte perserit perbrenda mëjë dhë pshtët-ë mendjën t' imë qe shkët më Shpirt zoteror; qe te vlëresohëm te bëj urdherimët ë tua per dite, i udhëhëqur me te dobishmët préj Shpirtit tënt te mire, dhë te kujtoj gjithenje ardhjën tëndë te lavderuar dhë nxonitesë te véperimëvë te mia; dhë mos me lër te genjëhëm më defrimët ë prishura te botes, po forcôm'a ënden per gezimin ë thësarevë per te ardhur. Së ti thé, ô Zot, qe çfaredô qe te lype nonje me ëmerin tënt, ë mërr pa péngim préj Pérendise dhë Atit tënt te bashkamëshuar; perandaj dhë une mekatari, më permiardhjë ë Shpirtit tënt Shënjt, i lutëm miresise s' atë: Sa t' u-luta ëpm'i per shpetim. Pô, ô Zot, ô dhuronjes i mire dhë i pasur préj ç' dô mirebërjëjë, së ti jë qe jëp më te tëper atò qe te lypim. Ti jë i dhëmpshuri, meshireploti, qe piësetovë pa mekat nga trupi yne, qe ëpësh dhempsherisht ner atà qe te ëpin gjunjet dhë qe na i çperlavë mekatët. Dhurô-i pra, ô Zot, popullit tënt meshirimët ë tua; degjô-na préj qiëllit tënt te shënjte; bëkô-i më fuqin' ë dores s' atë se diathte; mbulô-i nene hiën ë krahevë te tû; mos i perhith véprat ë duarvë te tua. Té ty vétëm mekattojme, po dhë ty vétëm adhurojme; nuke dime t' i falëmi nonje Pérendië te huaj, as t' i ngrëme duarte tona me tiater Pérendi, ô Zot. Ndiëna-i fajët tona dhë, dyké pritur lutjët tona me-gjunazi, ndëh dore ndihmesë mi né te gjithë; prit faljën ë te gjithëvë si témian te

mirepritur qe ngrihët perpara mbrëterise s' até se fortmire.

Pastaj shton dhé ketë URIM :

O Zot, ô Zot, qe na shpetovë préj çdô shigjété qe fluturon ditën, shpetô-na dhé préj çdô gjëjë qe fluturon n' érrësire. Prit si thërorë te mbrëmëshmë ngritjët é duarvë tona. Dhé vlëresô-na te shkojme hopin é nates pa mekat dhé pa u-ngare préj te keqiash; dhé çlirô-na préj çdô trubullimi dhé friké qe riëth préj Diallit mi né. Dhuroj-u shpirtévë tona vénërim dhé mendimévë tona kudjës per çprovimin me gjyqin tënt te frikshim é te dréjte. Mberthëj-i mishërat tona mé friken tëndé dhé vrana-i misët é dhëshmé; qe te gezohëmi dhé ne qétesì te gjumit mé pamjën é gjyqévë te tua. Largô préj nësh çdô fantasì te pahiéshmë dhé te dëmçimë. Dhé ngrër-na me kohen é faljës, te pshtëtur me bésen dhé te perparuar ner urdherimët é tua.

DIAKU : Perkraha-na, shpetô-na, meshirô-na, ngrër-na, dhé ruaj-na. ô Pérendì, mé hirin tënt.

Tëshënjten, te pacinuaren...

PRIFTI : Mé mirpelqimin dhé hirin é te vétëmit t' yt-Bir, mé te cilin jë i békuar, bashke mé Shpirtin tënt tëshënjt, te mire dhé jetëdhënes, tanì é perbére, dhé ne jéte te jétevé. Amen.

Pastaj : Vlëresô-na, ô Zot...

DIAKU : Perserì dhé perserì, dyké rêne me gjunje, Zotit lé t' lutëmi.

Dhé PRIFTI thote ketë URIM :

O Krisht Pérendia jone, burim jétedhënes dhé ndrìçonjes qe buron gjithënjë, fuqì kriëtaré é bashkamëshuar é Atit, qe mbarovë tëre ékonomine per shpetimin é njëresvë fort bukur; qe dermovë vargojt' é pazgjidhur te vdëkjës dhé klyçët é Férrit, dhé shkëlë neper këmbe shumicat é frymeravë te liga; qe blatovë vétën tëndé si thërorë te panjollëshmë per né, dyké dhëne me thërojë trupin tënt te pacinuar, te paprëkur é

te pashkëlur préj nonje mekati, dhé na falé jéten é amëshuar mé anen é kesaj méshé te frikshimé dhé te patrëguarshmé; qe zbrité ne Férr dhé dermové llozét é perjëteshme, dhé u trégové ngjitjén lart atyrévé qe rrinin n' érrësire; dhé grépové mé lak te hyjurte dranguan é kryélik dhé te gropeshme, dhé é lidhé ne Tartar mé radhe sketérré, dhé é burgosé ne ziarrin é pashuar dhé ne érrësiren mê te perjashtmé mé potéren tëndé te paaneshmé; urtesia émermadhé é Atit; qe u-duké ndihmes i math per te ngaret, dhé ndriçové atà qe rrinin n' érrësire dhé ne hié te vdékjés; ti, ô Zot i lavdise s' amëshuar, dhé Bir i dashur i Atit te larte; drit' é amëshuar préj drité t' amëshuar; ô Diéll' i dréjtesise, degjô-na né qe po te lutémi, dhé prêh-i shpirtét é sherbetorevé te tû, te atervé dhé vellézervé tane qe kane fiétur perpara nësh, dhé te gjirijvé misheroe te tiére, dhé te gjithë njëresvé tane te béses, kujtimin é te cilevé po bëjme tanì; sé me ty eshte potéra mi te gjitha, dhé ti mban ne dore gjithë anet é dhéut. Zot i tèrefuqishim, Pérendì é Atervé, dhé Zot i meshires, Krijétar i gjindjés se vdékshimé dhé se pavdékshimé dhé i gjithë natyres njërezoré qe lidhét é zgjidhét, i jétes dhé i vdékjés, i ardhjés ketu dhé i vajtjés atjé; qe mat vitét é te gjallevé, dhé perfundon koherat é vdékjés, qe kall ne Férr dhé nxiér préj tij, qe lith ne semundjé dhé shpeton mé fuqì; qe urdheron perdorisht te tanishmét, dhé sundon fitimerisht te nésermét; qe u jép jéte mé shprésen é ngjalljés atyrévé qe jane goditur préj thumbit te vdékjés. Ti, ô Zot i te gjithëvé, ô Pérendì dhé Shpetimtari yne, shprésa é gjith' anevé te dhéut dhé t' atyrévé qe ndodhén ner détét lark, qe dhé ne ketê ditén é funtmé, te madhé, dhé shpetimtaré te Rushajévé na trégové myshtérin é Trinise se shénjte, se bashkeqênurshmé, se bashkamëshuar, se pandare, dhé se paperziére, dhé qe dérdhé permindohjén dhé

ardhjen é Shpirtit tËnt te shËnjte dhé jËtedhËnes, ne forme gjuherash ziarri, mi Apostujt é tËu te shËnjte, dhé i vendosé Ungjillore te bËses s' one piozÉ, dhé i trégovÉ rrefËnjes dhé leqites te ThÉologise se vertËte; qe dhé ne ketË te KrËmtÉ te mbaruar dhé shpetimtarÉ dËnjovÉ te prËç faljÉ lutjËsorÉ per atà qe permbahËn ne FËrr, dhé na jËp shprËsa te medha t' u dergohËt prËj tËjË ngushellim dhé pushim hidherimËsh atyrévÉ qe ndrrojne jËte; degjô-na né te perunjurit dhé te mjËret qe po te lutËmi; dhé prËh-i shpirtËt é sherbetorevÉ te tu te parefËtur ne vent te ndrËçim, ne vent te lendineshim, ne vent rifrËshkimi, ngaha ka ikur ç' dô dhembjÉ, hidherim dhé pshËretim; dhé vendos-i shpirtËt é tyrÉ ner tËnda te DrËjtËsh, dhé vlËresô-i per paqe dhé prËhjÉ; sé nuke do t' te lavderojne te vdËkurit, ô Zot, as atà qe jane ne FËrr do te kuxojne te te blatojne lavderim, po né te gjallet te békojme dhé te lutËmi, dhé te blatojme urimËt dhé thËrorËt tona çpiatorÉ per shpirtËt tona.

Dhé pastaj shton ketË URIM :

O Pérendi é madhé dhé é amËshuar, é shËnjte dhé njËridashesÉ, qe na vlËresovÉ dhé me ketË ore te qendrojme perpara lavdise s' até se paaferuar per hymné dhé levdim te çudiravÉ te tua, lé te te vije kËq per né sherbetoret é tËu te pavyér, dhé fal-na hirin te te blatojme pa u-tronditur mé zemer te thyËr lavderimin é trishËnjte dhé perhirimin per dhuratat é tua te medha qe na bËré dhé na bËn kurdohére. Kujtô, ô Zot, dobesine tone, dhé mos na hump bashke mé paudhesite tona, po madhô-é perdellimin tËnt per perunjËsine tone qe, dyké ikur nga érresir' é mekatit, te barËsim me dite drËjtËsiÉ; dhé, dyké vËshur arme dritÉ, te mbËtËmi lark çdô véperimi te nakarshim te te ligut, dhé te lavderojme shËshit permi te gjitha ty, te vétëmin

Pérendi te vertéte dhé njëridashes. Sé myshtëri yt eshte mé te vertéte, ô Zot dhé krijëtar i gjithësisë, dhé zgjidhja é perkoheshmé é kriësavé te tua dhé bashkelidhja é pastajmé dhé prëhja per jëte. Ty te perhirojme per te gjitha, per hyrjën tone me ketë bote dhé per daljën, é cila vlëserohët mé shprësen tone per ngjalljën dhé per jëten é amëshuar pas zotimit tënt te vertéte; te cilen é gezofshim me ardhjën tëndé te dyte qe présim. Sé ti jë kryëtar i ngjalljës s' one dhé gjykatesi i paëpur dhé njëridashes i atyrévë qe rrojtin dhé Zot é Miështer i çperblimit; ti qe piësetovë peraferisht mé né préj mishit dhé préj gjakut nga dénjimi i math, dhé na u-bëré ndihmes i véteftuar névé te ngarevé, nga qe pesové dhé u-ngavé véte, dhé qe i meshirové pasionët tona te paperikura, nga qe i provové véte, dyké dashur, dhé perandaj na mblodhé ne apathinë tëndé. Prit pra, ô Zot, faljët dhé lutjët tona dhé prëh-i aterit é cilitdô dhé nënat dhé vellëzerit dhé motrat dhé femijen dhé gjithë njekombasit dhé njefaresit dhé gjithë shpirtët é pareprëhur mé shprëse ngjalljéjé per jëte t' amëshuar; dhé vendos-i shpirtët dhé émerat é tyré té libr' é jëtes, té gjir' i Abrahamit, Isaakut dhé Jakobit, té vendi i te gjallévë, té mbrëteri' é qiëjvé, té Parajs' é gezimit, dyké i shpëne te gjithë ner tëndat é tua te shénjta mé anen é Engjëjvé te tû te ndrëçim; mblidh-i dhé trupët tona me ditën qe ké fiksuar pas zotimévë te tua te shénjta dhé te vertéta. S' ka pra, ô Zot, vdëkjé per sherbetoret é tû, kur mergohëmi préj trupit, dhé vijme té ty Pérendia, véç ndrërim nga hëlmët ner më te mirat dhé më te shpirt-pelqyérat dhé prëhjé dhé gezim. Dhé, ne qofte sé mekatuam me ty, trëgohu i meshireshim per né dhé per atà, sé s' ka te spastruar préj njollé, dhé nje dite ne mbajte jëta, véç tējé vétem qe u-rrefévë mi dhé i pamekateshme, ô Zoti yne Jësu Krisht, mé anen é te cilit shprësojme te gjithë te marrim perdellim dhé

ndiése mekatésh. Perandaj, si névé si atyré, si Pérendi é mire dhé njéridashesé, hiqna-i, ndjéna-i, falna-i paudhesite, te dashura dhé te padashura, nga dija dhé nga padija, te çfaqura dhé te fshéhura, mé pune, mé mendjë, mé fiale, mé kuvendimé, dhé mé levizjë; dhé atyrévé qe shkuan perpara fal-u lirè dhé prêhjé, dhé békô-na né qe rrimë rrotull; dhurô-na mbarim te mire dhé te paqeshme névé dhé tère popullit tënt, hap-na zemren njéridashesé dhé meshireploté mé ardhjén tëndé te tremçimé dhé te frikshimé dhé bê-na te vyér per mbréterine tëndé.

Pastaj shton dhé ketë URIM :

O Pérendi é madhé dhé é larte, i vétëmi i pavdékshim, qe banon me driten é paaferuar, qe krijové tère kriésen mé urtesì, dhé ndavé driten nga érrësira, dhé i dhè diéllit potére mi ditën dhé hênes mé yjte potére mi naten; qe na vléresové né mekataret dhé me ditën é sotmé te dalim perpara téje mé lavderim, dhé te te blatojme adhurimin é mbrëmëshme; ti, ô Zot njéridashes, dréjtesô lutjén tone si témian perpara téjé dhé prit-é si ére lulésh. Dhé fal-na ketë mbrème dhé naten qe vjén te paqeshmé; vésh-na mé arme drité; shpetô-na nga frika natoré, dhé nga çdô gjé qe barét n' érrësire; dhé, dhurô-na gjumin, qe na falé si prêhjé per dobesine tone, te çliruar préj çfaredô fandasié diaboliké. Pô, ô Zot i te gjithavé, fales i te miravé; qe, dhé ner shtratét tona dyké u-çlodhur, te kujtojme dhé naten émerin tënt te gjitheshénjte; dhé te ndriçuar ne méjtimin é porosivé te tua, te sqohémi mé ngazellim shpirti per te lavderuar miresime tëndé, dhé t' i blatojme dhempsherise s' até faljë dhé lutjë per mekatét tona dhé te tère popullit, te cilin é veshtrô mé perdellim mé nermjetimét é Hyjlindesés se shénjte.

DIAKU : Perkraha-na, shpetô-na, meshirô-na, ngrër-na, dhë ruaj-na, ô Pérendi, mé hirin tënt.

Têreshénjten, te pacinuaren...

PRIFTI : Sé ti jë prëhja é shpirtévë dhë é trupévë tona, dhë ty te dergojme lavdi, Atit...

DIAKU : Lé t' ia mbarojme lutjën tone...

PRIFTI : Sé ti jë Pérendi é mire dhë njëridashesë dhë ty te dergojme lavdi, Atit...

DIAKU : Krëret tuaja Zotit unjiani.

POPULLI : Ty, ô Zot.

Dhë PRIFTI thote fshëhurazi ketë URIM :

Zot, Pérendia jone, qe unjë qiëjte dhë zbritë per shpetimin é gjindjës se njëresvé, hith syrin mi sherbetoret é tû dhë mi trashegimin tënt; sé ty, Gjykatesit te frikshim dhë njëridashes sherbetoret é tu te unjne krëret, jo dyké pritur ndihme préj njërezish, po dyké pritur perdellimin dhë shpetimin tënt; te cilet i ruaj me çdô kohe, dhë ketë mbrëme dhë naten qe vjën préj çdô armiku, préj çdô véperimi kundreshtar, préj çdô mendimësh te kotta dhë préj çdô kujtimësh te liga.

Pastaj PRIFTI therrët :

Ofte potëra é mbrëterise s' até é bëkuar dhë é lavduar, é Atit...

Pasvargjë. — T. III.

Tani ardhe gjuherat shëshit si shënje per te gjithë; sé Judëjte, préj te cilevé ardhi truperisht Jësuj, u-semure nga pabësia dhë rane préj hirit pérendor, dhë né paganet u-vlëresuam per driten é hyjeshmé, te pshtëtur mi fialet é Dishëpujvé, qe fole lavdin' é Pérendise, mirebêresit te gjithesise; mé te cilet, dyké unjur zemrat dhë gjunjet, dhë te pshtëtur préj Shpirtit Shënjt, lé t'adhurojme mé bése Shpetimtarin é shpirtévë tona.

Vark. — Krijô zemer te kthiëllet té mua, ô Pérendi.

Tani Shpirti Ngushellimtar u-dërth mi ç' dô trup; sé, dyké nisur préj shoqerise s' Apostujvé, ndëu hirin

prëj syrësh mi bësniqet si piësetim, dhë provon permindodhjen ë tij te potëreshmë, dykë perndare gjuherat ner Apostujte ne forme te ziarrte per hymnim dhë lavdì te Pérendise; perandaj, më zemera te shkelqyëra menderisht, dhë te pshtëtur ne bëse prëj Shpirtit Shënjt, lutëmi qe te shpetohën shpirtët tona.

Vark. — Mos me hith tëj prëj faqës s'atë.

Tanì vishën më potëre qe lartazi Apostujt ë Krishtit; sé i perserit Ngushellimtarì, dykë u dhëne dije myshtikë te ré; te cilen ë leçitne më gjuhera te huaja dhë lartfolesë, dhë na mesuan te adhurojme natyren ë amëshuar te njeshmë dhë te triqënurshmë te Pérendise, mirebëresit te gjithesise. Perandaj, te ndriçuar nga mesimët ë tyrë, lé t' adhurojme Atin më Birin dhë më Shpirtin, dhë lé te lutëmi te shpetohën shpirtët tona.

Lavdì ë Tanì. — T. T. IV. — Ejani, ô popuj, t' adhurojme... (Shih më sipër ne Mbrëmesorë).

Tanì perleshô-ë sherbetorin tënt...

Shënjt Pérendì...

Perleshorja ë se Krëmtës. Pastaj PRIFTI bën ketë PERLESHIM :

Krishti, Pérendia jone ë vertëte, qe zbriti nga gjiri prinderor, dhë mori natyren tone te njërezishmë dhë ë hyjesoj, dhë pastaj u-ngjit ner qiëjte perserì dhë ndenji me te diathte te Pérendise dhë Atit, dhë u dergoj Shpirtin ë tij te Pérendishme, te Shënjte, te bashkeqënurshme, te bashkelavdishim dhë te bashkamëshuar Dishëpujvé dhë Apostujvé te tij te shënjte, dhë ndriçoj atà, dhë më anen ë tyrë tëre gjithesine, më nermjëtimët ë Nënes tij se panjollëshmë dhë se pacinuar, t' Apostujvé te shënjte, te lavderuar, ëmershkelqyër, Hyjleçites dhë Shpirtprures, dhë te gjithë Shenjtorevé, na meshirofte ë na shpetofte pas miresise se tij. Amen.

E DIËLA Ë GJITHE SHENJTORËVË

Perleshoré. — T. IV.

Kisha joté, é stolisur mé gjakrat é Deshmorevé te tû ne tère Boten, si mé purper dhé vyshe, te therrét mé anen é tyré, ô Krisht Pérendi : Dergô meshirimét é tua mi popullin têt, dhurô-i shtétit têt paqen dhé shpirtévé tona perdellimin é math.

Shkurtoré. — T. T. IV.

Bota te blaton, ô Zot, mbiélles i kriéses, Deshmoret hyjprures si kulloshtre te natyres. Mé lutjët é tyré ruaj-é Kishen tëndé ne paqe te thëlle mé anen é Hyjlindesés, ô meshireplot.

(Per Apostull dhé Ungjill shih té Libr' é te Krémlévé te Medha f. 253).

LISTA É NDIHMETAREVÉ

BUKURÉSHT

Petro H. Tarpo frênga 500, Thoma Çami 300, Kristo V. Tarpo 300, Vissarion A. Dodani 300, Ahilé Efthim 100, Vasil Zografi 150, Efthim Emanuil 100, Thanas Kandili 80, Irakli Duro 60, Kristo Gajo 40, Vellézeria Kosturi 40, Vellézeria Visso Emanuil 40, Vangjél Dimitri 40, Kristaq Kottadi 20, Naum A. Ciko 40, Kristaq dhé Efthim Biga 60, Vellazeria Bushi 10, Vellazeria Péço 40, Vellazeria Th. Gjérman 20, Vellazeria Soviani 20, Nikoll Kristo Perméti 20, Irakli J. Mborja 50, Daniel M. Çélo Frasheri 5, Mihallaq Kirica 20, Gabriel Péma 40, Ilia S. Buzi 20, Pandéli Vangjél 40.

BRAILLE

Stérjo Sotir 20, Naqi Boci 6, Gjérq Boçari 20, Kosta D. Lito 10, Arsén V. Nasé 6, Kosta Naum Kotorri 5, Naum Dini Kotorri 20, Kristo Papa Nikolla 10, Sotir A. Xoxé 20, Nikolla Z. Stavro 10, Spiro Marko 10, Januli G. Nasé 5, Mihal N. Gogollari 10, Vasil D. Zisso 5, Kiço A. Mitrushi 5, Mihal G. Nasé 5, Anastas V. Xoxéllari 5, Gaqi Llazo 5, Pétro Rizo 5, Dimitri Janaqi 10, Dimitraq Théodor 3, Jani Boçari 5, Anastas N. Xéxéllari 5, Anastas Nikolla 5, Kristo N. Balashi 5, Kristo Nédéli 1, Vangjél Naqi 5, Kosta N. Mitrushi 5, Nasho Mitrushi 2, Pétri Pando 5, Kosta Stéfan Pétro 5, Anastas

Poda 5, Théodos Papa Nikolla 10, Nikolla Gjanato 3,
Stavré Gjérgji 5, Kristo Duka 6, Dimitri Pando 5,
Anastas H. Cocka 5.

Note. — Listat é ndihmetarevé te tjére jane shtypur
ne funt te LUTJËSORËS.

LENDA É LIBRES

Pashka é Madhé	fagé	9
E Diéla é Shen Thomajt	»	23
E Diéla é Myrreprursévé	»	30
E Diéla é Ulokut	»	36
E Diéla é Samaritanés	»	41
E Diéla é te Vérberit	»	48
Shéstja	»	55
E Diéla é Shen Atervé	»	64
Rushajét	»	69
Lista é Ndihtetarevé	»	91

